



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 189 Akti

Nr. 262 Vendimi

Tiranë, më 17.6.2020

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 1, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                            |          |
|----------------------------|----------|
| <b>Roland Ilia</b>         | Kryesues |
| <b>Valbona Sanxhaktari</b> | Relatore |
| <b>Xhensila Pine</b>       | Anëtare  |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në datën 11.6.2020, ora 9:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Edlira Petri**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Edlira Petri është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit si gjyqtare në Gjykatën e Apelit, Tiranë. Bazuar në pikën 4, të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 23.9.2018, është vendosur kryesues z. Roland Ilia dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 11.3.2020, trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Petri, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe prova shkresore lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, brenda afatit të përcaktuar.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Petri, në seancë dëgjimore datë 11.6.2020, ora 9:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 11.6.2020, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.
9. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë dhe në përfundim të saj, kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Edlira Petri në seancën e datës 17.6.2020, në të cilën subjekti ishte i pranishëm.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi, lidhur me rrethanat e çështjes.
12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti në këtë institucion në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese;
- d) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- e) dokumente shpresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- f) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- g) shpjegimet me shkrim dhe provat shpresore të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- h) denoncimet nga publiku.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>2</sup>.

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Petri, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratimeve të bëra nga subjekti në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka deklarim të rremë, konflikt interesi, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Në deklaratën e pasurisë “Vetting” subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Petri, ka deklaruar pasuri në zotërim 100 %, si më poshtë:

- a) automjet tip “Mercedes Benz”, blerë në vitin 2009;

<sup>1</sup> **Procedura e vlerësimit të pasurisë** 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.

<sup>2</sup> Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

- b) depozitë në “Credins Bank”, në vlerën 1.307.748 (një milion e treqind e shtatë mijë e shtatëqind e dyzetë tetë) lekë;
- c) llogari në “Credins Bank”, në vlerën 2.055.253 (dy milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

18. Automjet tip “Mercedes Benz”, blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 10.6.2009, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga.

19. Nga hetimi ka rezultuar:

- DPSHTRr-ja<sup>3</sup> konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit është regjistruar automjeti tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 1998, duke vënë në dispozicion dosjen e këtij automjeti;
- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti deklaroi zotërimin e automjetit tip “Mercedes Benz”, me targa \*\*\*, nëpërmjet aktit të përdorimit<sup>4</sup> nr. \*\*\*, datë 13.10.2007. Subjekti deklaroi se në momentin e marrjes në përdorim, pronari aktual nuk e dispononte (nuk ishte përpiluar ende nga organi kompetent) certifikatën e pronësisë së automjetit;
- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti deklaroi fitimin e pronësisë së automjetit dhe pajisjen me leje qarkullimi datë 18.10.2010 dhe se çmimi është parapaguar në vitin 2007. Pronësia mbi këtë automjet është fituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 10.6.2009;
- ILDKPKI-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019, ka vënë në dispozicion të Komisionit procesverbalet e mbajtura me subjektin e rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e dorëzuar prej saj, ndër vite. Në procesverbalin e datës 17.7.2009, subjekti ka sqaruar se vlera e dakordësuar për blerjen e automjetit është 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, e cila është paguar në momentin e hartimit të aktit të përdorimit, si dhe dorëzon, ndër të tjera, kontratën e shitjes së këtij automjeti.

20. Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e këtij automjeti, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme në vitin 2007 për blerjen e automjetit.

| Përshkrimi   | Vlera          |
|--|----------------|
| Blerje automjeti tip “Mercedes Benz” datë 17.10.2007 | 600 000        |
| Ndryshim në likuiditete deri më 17.10.2007           | -112 058       |
| <b>TOTAL pasuri</b>                                  | <b>487 942</b> |
| Të ardhura nga paga janar - tetor 2007               | 829 460        |
| Shpenzime jetike janar - tetor 2007                  | 113 850        |
| Shpenzime TIMS E. Petri janar - tetor 2007           | 187 411        |
| <b>TOTAL shpenzime</b>                               | <b>301 261</b> |
| <b>Rezultati financiar</b>                           | <b>4058</b>    |

21. **Depozitë në “Credins Bank”, në datën 5.1.2017, me gjendje në vlerën 1.307.748** (një milion e treqind e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e tetë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga, hapur në datën 8.2.2013, sipas kontratës së depozitës. Zotërimi: 100 %.

22. “Credins Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2019, konfirmon depozitën në emër të subjektit dhe paraqet veprimet e kryera, të cilat së bashku me vlerat përkatëse janë përfshirë në analizën financiare.

23. **Llogari në “Credins Bank”, në datën 5.1.2017, gjendja në vlerën 2.055.253** (dy milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë. Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat. Zotërimi: 100 %.

<sup>3</sup> Shihni në dosjen e Komisionit shkresën nr. \*\*\*, datë 12.2019.

<sup>4</sup> Me prokurën e posaçme nr. \*\*\* rep., datë 13.10.2007, z. P. A., emëron subjektin si përfaqësuese të veçantë, së cilës i lë të drejtë dhe kompetencë të plotë për ta përfaqësuar për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e certifikatës së pronësisë për automjetin tip “Mercedes Benz”.

24. “Credins Bank” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2019, konfirmon depozitë në emër të subjektit dhe paraqet veprimet e kryera, të cilat së bashku me vlerat përkatëse janë përfshirë në analizën financiare.

**25. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjeve në depozitën dhe llogarinë bankare më sipër (p. 21, 23). Deklarimet e subjektit përputhen me rezultatit e hetimeve të kryera nga Komisioni.**

**Në Deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar gjithashtu pasuritë, si më poshtë:**

26. **Apartament, me sip. 99.5 m<sup>2</sup>**, në Qerret, pasuri e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit sipas Certifikatës së Pronësisë datë 15.6.2012. Në Deklaratën “Vetting” subjekti sqaron se ky apartament është blerë nga bashkëshorti në vitin 2006, përpara martesës.

27. ZVRPP-ja Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2019, informon se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit rezulton e regjistruar pasuria apartament me sip. 99.5 m<sup>2</sup>, në Qerret: (a) me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.5.2012, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., i shet z. S.S., apartamentin në vlerën 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro; (b) me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.12.2011, “Për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit” nga ALUIZNI është përfituar kundrejt vlerës 65.442 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dyzet e dy) lekë<sup>5</sup>, trualli me sip. 710.27 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi edhe me të tjerë.

28. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti deklaroi se pasi është kaluar dhe bashkëpronësia mbi truallin me kontratë nga ALUIZNI është bërë edhe regjistrimi në ZVRPP-në Kavajë, i pronësisë mbi apartamentin në Qerret, Kavajë (e deklaruar kjo pasuri nga bashkëshorti në deklaratimet e mëparshme).

29. Subjekti, gjatë hetimit administrativ, shpjegon<sup>6</sup> se në shtator të vitit 2006 z. S.S., lidhi kontratë me shoqërinë “\*\*\*”, për ndërtimin e një apartamenti në Qerret, Kavajë kundrejt çmimit 58.750 euro, i paguar në momentin e lidhjes së kontratës. Apartamenti i është dorëzuar blerësit S. S., po atë vit.

30. Subjekti deklaroi se nuk ka marrë pjesë në asnjë veprim juridik për blerjen e këtij apartamenti dhe se të gjitha veprimet juridike janë kryer nga bashkëshorti përpara martesë. Subjekti sqaron se e ka deklaruar apartamentin për shkak të regjistrimit në ZVRPP të kësaj prone në emër të të dy bashkëshortëve, por vlerëson se e drejta e pronësisë i përket vetëm bashkëshortit, i cili ishte titullar i së drejtës reale mbi ndërtimin e blerë prej tij para martesës.

31. Apartamenti në Qerret, Kavajë, i kontraktuar në vitin 2006, është ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*”, bazuar në ligjin nr. 7665, datë 21.1.1993, “Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin”, i ndryshuar, të cilat ndërtoheshin në toka me pronar shtet. Me lidhjen e kontratës nga z. S. S., u përfituan rrjedhimisht edhe të drejta reale mbi këtë pasuri. Pikërisht, për shkak se z. S. S., ishte mbajtës/titullar i kësaj të drejte reale mbi apartamentin, përfitoi edhe të drejtën e blerjes së truallit nën të, së bashku me bashkëpronarët e tjerë të pallatit ku ndodhet apartamenti, bazuar në ligjin nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”. Mbi këtë bazë, gjatë vitit 2011, ka filluar dhe është kryer procedura për blerjen nga ALUIZNI të truallit në bashkëpronësi mes të gjithë pronarëve të apartamenteve të pallatit. Me blerjen e truallit, subjektit të interesuar i lindi e drejta e regjistrimit të kontratës për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi ndërtimin, lidhur mes tij dhe personit të stimuluar. ZVRPP-ja Kavajë, kryesisht, ka kërkuar si dokument edhe certifikatën e përbërjes familjare dhe duke qenë se pas

<sup>5</sup>Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kaluar nëpërmjet “Credins Bank” pagesën për truallin.

<sup>6</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 30.8.2017.

- gushtit të vitit 2010, subjekti figuronte si bashkëshorte e z. S.S., e regjistroi pronën në bashkëpronësi të të dyve.
32. Nisur nga fakti që z. S.S., ka lidhur kontratë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për ndërtimin e një apartamenti në Qerret, përpara martesë, dhe se vlera prej 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro rezulton e paguar përpara martesës me subjektin e rivlerësimit, hetimi i kryer nga Komisioni mbi burimet e krijimit të këtij apartamenti trajtohet më poshtë në këtë vendim.
33. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi automjet tip “Renault Twingo” në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë plus 180.000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë tarifë doganore.
34. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti nuk e deklaroi çregjistrimin e këtij automjeti. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, bashkëshorti i subjektit, çregjistrimin e këtij automjeti e deklaroi nxjerrje jashtë përdorimi.
35. DPSHTRr-ja vendos në dispozicion dosjen e automjetit tip “Renault Twingo”, viti i prodhimit 1994, nga ku rezulton se subjekti e ka blerë automjetin në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 10.3.2005, i zhdoganuar për vlerën 182.180 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë, në datën 17.4.2005. Automjeti është çregjistruar më 29.3.2012.
36. Vlera totale prej 330.000 (treqind e tridhjetë mijë) lekësh (çmim blerje + shpenzime zhdoganimi) është përfshirë në analizën financiare për vitin 2005.
37. Nga analiza financiare rezulton se subjekti justifikon me burime të ligjshme blerjen e automjetit. Lidhur me faktin e mosdeklarimit të mospërdorimit të automjetit dhe çregjistrimit të tij, në deklaratën periodike vjetore përkatëse, trupi gjykues vlerësoi se është një pakujdesi e paqëllimshme në deklaram.
38. Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003 – 2009, subjekti i rivlerësimit deklaroi vendbanimin në adresën: Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, Tiranë (banesë e prindërve).
39. Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, për prindërit e subjektit të rivlerësimit, nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>7</sup> është marrë informacioni se në emër të babait të subjektit, z. Dh. P., figurojnë pasuritë:
- apartament me sip. 72 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë, në Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, Tiranë, fituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 21.7.2000;
  - apartament me sip. ndërtimi 80.35 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, fituar me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 25.2.2013, për objektin “shtesë kati në objektin ekzistues 5 kate”.
40. Sipas informacionit rezulton se z. Dh.P., së bashku me tre shtetas të tjerë, legalizojnë sipërfaqen e ndërtimit për banim prej 253.95 m<sup>2</sup>. Nga formulari i vetëdeklarimit nr. \*\*\* prot., datë 10.11.2006, rezulton se mbi godinën ekzistuese banorët e katit të pestë kanë ngritur katin e gjashtë me sip. ndërtimi 274.15 m<sup>2</sup>. Formulari i vetëdeklarimit është bërë nga njëri prej banorëve.
41. E pyetur lidhur me këtë shtesë dhe investimin e kryer, subjekti ka deklaruar<sup>8</sup> se është ndarë nga përbërja familjare që në periudhën kur ka qenë studente (në vitin 1997), por ka jetuar me prindërit në adresën e deklaruar prej saj, e cila është shtëpia e tyre.
42. Lidhur me shtesën e katit (apartament me sip. ndërtimi 80.35 m<sup>2</sup>), subjekti deklaroi se nuk ka asnjë lidhje me ndërtimin e kryer dhe nuk është përfshirë, pyetur apo kërkuar miratim për realizimin e tij. Kjo shtesë është kryer nga të gjithë banorët e katit të fundit të pallatit dhe njëri prej fqinjëve u mor në emër dhe për llogari të të gjithëve, si me ndjekjen e procesit të ndërtimit, ashtu edhe me procedurat e legalizimit. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur një deklaratë

<sup>7</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2019.

<sup>8</sup> Pyetësori i datës 9 janar 2020, përgjigjja nr. 2.

noteriale, të nënshkruar nga banorët në vitin 2006<sup>9</sup>. Subjekti sqaron në vijim se vëllai i nënës së saj dhe një kushëri i saj tregtar, kanë kryer punime dhe siguruar materialet e ndërtimit për shtesën.

43. Subjekti, e pyetur në lidhje me shpenzimet e kryera për këtë shtesë dhe burimin e financimit, deklaroi se sipas informacioneve të marra nga prindërit (të cilat, ndonëse kanë nisur në vitin 2006, kanë vijuar për një periudhë kohe dhe kanë përfunduar në vitin 2009), nuk ekziston dokumentacion ligjor. Ky ndërtim ishte informal dhe të njëjta ishin edhe pagesat që kanë kryer, pra, pa fatura. Mbështetur në deklaratimet e prindërve të subjektit, vlera totale e paguar prej tyre është rreth 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë.

44. Në lidhje me burimin e këtyre shpenzimeve, subjekti deklaroi se prindërit i kanë përballuar me të ardhurat që kanë pasur të depozituara në llogarinë bankare në bankën Italo-Shqiptare, duke vënë në dispozicion kopje të ekstrakteve të llogarive bankare të z. Dh.P. Subjekti shpjegoi se: *“Për sa ata kujtohen sot, detyrimet i kanë shlyer, një pjesë në vitin 2008 dhe pjesën e mbetur në muajt e parë të vitit 2009, me vlerat e tërhequra nga këto llogari”*. Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur kopje të ekstrakteve të llogarive bankare të referuara.

45. Nga dokumentacioni bankar i administruar<sup>10</sup> nga Komisioni, ka rezultuar se z. Dh.P., ka pasur depozita bankare në ish-bankën Italo-Shqiptare (sot, “Intesa Sanpaolo Bank”), në periudhën 2004 – 2007, të cilat shtuar me interesa bankare deri në fund të vitit 2008, kanë pasur një vlerë totale prej 11.245 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) euro ose 1.381.245 (një milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë. Z. Dh. P., ka tërhequr *cash* vlerën 3.500 (tre mijë e pesëqind) euro, në datën 13.11.2008 dhe vlerën 7.713 (shtatë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) euro, në datën 5.2.2009, me përshkrimin “tërheqje për shpenzime familjare”.

46. Sipas informacionit të dërguar nga ISSH-ja<sup>11</sup>, z. Dh. P., trajtohet me pension pleqërie nga prilli i vitit 2004, në vlerën 27.250 (njëzet e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë/muaj dhe znj. B. P., trajtohet me pension pleqërie nga korriku i vitit 2015, në vlerën 17.804 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e katër) lekë/muaj.

47. Nga kopja e kontratës për furnizimin me energji elektrike, si dhe të dhënat e marra nga sistemi i OSHEE-së<sup>12</sup>, rezultoi se banesa ka filluar të përdoret në maj të vitit 2009.

48. Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi mospërputhje të deklaratimit për sa i përket vitit të ndërtimit, sipas formularit tek ALUIZNI, i cili rezultoi i dorëzuar në datën 10.11.2006 dhe evidentohet se ndërtimi është kryer në vitin 2006 dhe deklaratimeve të subjektit se burim për këtë ndërtim kanë qenë kursimet e prindërve në llogaritë bankare, të cilat rezultojnë se janë tërhequr përgjatë viteve 2008 – 2009. Për këtë, subjekti iu kërkoi shpjegime lidhur me këto mospërputhje.

49. Në shpjegimet e tij, subjekti sqaroi se është i vërtetë fakti, që ka një diferencë në kohë, nga momenti i fillimit të ndërtimit dhe kur ky ndërtim konsiderohej i deklarueshëm për legalizim, si dhe momenti kur ndërtimi i llojit “banesë” u përfundua dhe u bë i shfrytëzueshëm për banim. E gjithë kjo periudhë përfshin punime ndërtimi të kryera në funksion të realizimit përfundimtar të objektit, që sikurse vërtetohet nuk ka ndodhur më parë se maji i vitit 2009, kur banesa u bë e shfrytëzueshme. Subjekti deklaroi se: *“Në këto rrethana, (nisur edhe nga shpjegimet që kam dhënë në pyetësin e mëparshëm), sikurse është rënë dakord mes prindërve të mi dhe një kushëriri të nënës, z. B. C., që kryente veprimtari tregtarë në fushën e ndërtimit, pagesa e parave do të kryhej në fund të punimeve. Me z. B. C., si kushëri i nënës sime është ruajtur një raport i shpeshtë njerëzor dhe i qëndrueshëm, ndaj kryerja e pagesës në fund të punimeve është e kuptueshme edhe për faktin se nuk përbënte asnjë problem financiar për të. Më lejoni edhe një herë që të insistoj në evidentimin e faktit negativ se unë, si subjekt rivlerësimi, nuk kam asnjë lidhje me këtë ndërtim, si në kohën e*

<sup>9</sup> Në këtë deklaratë, babai i subjektit të rivlerësimit dhe banorët, deklarojnë se kanë kryer shtesë kati mbi banesat ekzistuese.

<sup>10</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2019 nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2019, nga ISSH-ja.

<sup>12</sup> Subjekti ka dërguar kopje të dokumentacionit përkatës.

*kryerjes, ashtu edhe në vitet në vijim, duke mos fituar kurrë asnjë të drejtë reale apo kontraktore. Rregullimi i marrëdhënieve mes prindërve, si përfitues të ndërtimit dhe subjektit që i ndihmoi në realizimin e tij, është kryer tej çdo ndikimi, roli apo vullnetit tim personal”.*

50. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale<sup>13</sup> mes prindërve të saj dhe z. B. C., ku deklarojnë sa më sipër, thënë nga subjekti. Po ashtu, subjekti ka kërkuar që nëse vlerësohet nga Komisioni, z. B. C., mund të thirret për të dëshmuar lidhur me këto deklarime.

51. Në vlerësim të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit dhe shpjegimeve të subjektit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se kjo pasuri nuk i përket subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues nuk ka dyshime lidhur me këtë pasuri të prindërve të subjektit të rivlerësimit sepse nuk rezultuan fakte, rrethana apo prova që ta lidhin qoftë dhe indirekt subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri.

## **52. Pasuri të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit, z. S. S., në deklaratën “Vetting” janë:**

- apartament banimi me sip. 186 m<sup>2</sup>, blerë në vitin 1998, Tiranë;
- apartament banimi me sip. 81.69 m<sup>2</sup>, Tiranë, shtesë kati përfitur me leje legalizimi në vitin 2012;
- apartament banimi me sip. 99.5 m<sup>2</sup>, blerë sipas kontratës datë 5.9.2006, me vendndodhje Qerret, Kavajë;
- garazh, njësi shërbimi dhe 5 apartamente banimi në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, përfitur në këmbim të truallit me sip. prej 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesës mbi të;
- depozitë në “Credins Bank” në dollarë amerikan;
- depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në lekë;
- llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në euro;
- llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në lekë.

53. **Apartament banimi me sip. 186 m<sup>2</sup>**, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 18.3.1998, në vlerën 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë. Burimi krijimit: të ardhurat. Apartamenti rezulton në bashkëpronësi të shtetasve E., dhe K.S., (ky apartament është përfitur fillimisht nga privatizimi). Kjo pasuri është fituar nga bashkëshorti përpara martesës me subjektin.

54. ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se në emër të shtetasve S., E., dhe K.S., rezulton e regjistruar pasuria apartament me sip. 186 m<sup>2</sup>. Ky apartament është blerë nga Ndërmarrja Komunale Banesa Tiranë më 1.5.1997, nga familja e z. M.S., midis të cilëve edhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. S.S., dhe bashkëshortja e tij e ndjerë znj. E.S., në vlerën 14.856 (katërmëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë. Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.3.1998, shtetasit S., dhe E.S., blenë nga bashkëpronarët e tjerë apartamentin me sip. 186 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë me adresë: Blv. “\*\*\*\*”, Tiranë. Kjo vlerë, sipas kontratës, është paguar tërësisht nga blerësi. Ky apartament është rivlerësuar në vitin 2011, në vlerën 26.970.000 (njëzet e gjashtë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë.

55. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.4.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshohet dëshmia e trashëgimisë ligjore për shtetasen E. S., e cila ka vdekur më 17.7.2002, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë shtetasit S. S., E.S., dhe K.S.

## **56. Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.**

57. **Apartament banimi me sip. 81.69 m<sup>2</sup>**, me adresë Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, shtesë kati në objektin ekzistues deklaruar më sipër, legalizuar sipas lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 26.12.2012<sup>14</sup>. Vlera:

<sup>13</sup> Bashkëlidhur gjeni deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.3.2020.

<sup>14</sup> Me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 26.12.2012, legalizohet shtesë kati me sip.168.8 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasve H.Sh., dhe S.S.



1.638.095 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë, referuar situacionit. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare. Zotërimi: 100 %.

58. ZVRPP-ja Tiranë<sup>15</sup> konfirmon se në emër të z. S.S., rezulton e regjistruar pasuria apartament me sip. 81.69 m<sup>2</sup>, me përshkrimin në kartelën e pasurisë “shtesë kati në objektin ekzistues”, leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 26.12.2012. Sipërfaqja e ndërtimit të shtesës së z. S. S., sipas gent-planit, është 84.4 m<sup>2</sup>. Sipas aktekspertimit mbi realizimin e shtesës së katit nga konstruktore E. K., objekti është realizuar në shtator të vitit 2006, si dhe sipas situacionit të punimeve bashkëngjitur aktekspertimit, shtesa e katit është me sip. 81,69 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 1,638,095 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

59. ALUIZNI, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 14.2.2019, informon se z. S. S., është pajisur me leje nr. \*\*\*, datë 26.12.2012, shtesë kati në objekt ekzistues 3 kate, Njësia Administrative nr. \*\*\*, Tiranë. Me këtë leje z. S. S., dhe shtetasi H. Sh., legalizojnë shtesën me sip. 168.8 m<sup>2</sup>.

60. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, bashkëshorti i subjektit deklaroi: “...depozituar në zyrat e ALUIZNI-t një kërkesë për banorët e pallatit për legalizimin e ndërtimit, të kryer brenda kushteve teknike, si rrjedhojë e rikonstruksionit të çatisë së pallatit. Pagesa për pjesën e tij për sip. prej 85 m<sup>2</sup> nuk është kryer ende, për arsye se është caktuar për t’u paguar në vitin 2011.”

61. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, bashkëshorti i subjektit deklaroi: “mobilim shtëpi banimi për vitin 2011, në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë.”

62. Në deklaratën periodike vjetore, para fillimit të detyrës, dorëzuar më 18.12.2014, bashkëshorti i subjektit deklaroi të legalizuar në vitin 2010, apartamentin me sip. 81.69 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë, si shtesë kati në proces legalizimi.

63. Në pyetësin standard, subjekti shprehet se shtesa është ndërtuar nga z. H.Sh., dhe nga banorët e tjerë përpara vitit 2011 dhe se është deklaruar nga bashkëshorti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 në zërin mobilim/ndërtim, si shpenzim, vlera totale prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh nga e cila, vlera prej 1.638.095 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekësh i është paguar z. H.Sh., për punimet e kryera gjatë periudhës për realizimin e ndërtimit të tij sipas situacionit të punimeve<sup>16</sup>, ndërsa pjesa e mbetur është shpenzuar për mobilim (dhomë gjumi, kolltuqe etj.).

64. Me përgjigjet e pyetësorit të datës 30.8.2019, subjekti deklaroi se: “Apartamenti në pronësi të bashkëshortit tim dhe fëmijëve të tij (në origjinë i përfituar nga procesi i privatizimit të banesave), ndodhet në katin e tretë nga toka (të dytë teknik), të pallatit identifikuar si ‘\*\*\*’, i cili ishte edhe kati i fundit, mbi të cilin ndodhej tarraca. Pallati ka 2 hyrje, me vetëm dy apartamente në çdo kat, që do të thotë se nën tarracë ndodheshin katër apartamente. Në kushtet kur i gjithë kati u mbulua me ndërtime shtesë, pasi tre pronarët e apartamenteve të tjera kishin realizuar shtesë kati, duke mbetur pa u ndërtuar vetëm mbi apartamentin e bashkëshortit dhe fëmijëve, pronari i apartamentit të katit të dytë (nën apartamentin tonë), z. H.Sh., filloi realizimin e ndërtimit të katit shtesë. Situata ka qenë e tillë, që bashkëshorti i subjektit nuk mund të ndalonte realizimin e ndërtimit, ndërsa i kërkoi subjektit ndërtues z. H.Sh., që me përfundimin e ndërtimit dhe procedurës së legalizimit (nëse kjo do të ndodhte), duhej t’i njëjto të drejtat si bashkëpronar në tarracën e pallatit. Përgjatë kohës së ndërtimit prej tij dhe në vijim, shtesa ishte e palegalizuar dhe, për rrjedhojë, nuk ishte një send në qarkullimin civil, sikurse ishte edhe e pashfrytëzueshme për shkak të mospërfundimit tërësor të punimeve të brendshme. Në vitin 2010, z. H.Sh., realizoi ndarjen faktike të sipërfaqes shtesë ndërtimore, si dhe bazuar në situacionet e ndërtimit, të vëna në dispozicion prej tij, u pranua njohja e së drejtës së bashkëshortit të subjektit mbi këtë sipërfaqe (1/2 në pjesën perëndimore të ndërtimit), kundrejt detyrimit për pagimin e vlerës së ndërtimit. Megjithatë ndërtimi, shtesë kati, u

<sup>15</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 13.10.2017.

<sup>16</sup> Situacioni i punimeve pa datë është bërë nga ing. L.B., dhe ing. H.T., në vlerën 1.638.095 lekë.

realizua nga z. H.Sh., dhe jo nga bashkëshorti i subjektit, nuk është deklaruar ky fakt në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006. Vetëm në vitin 2010, në kushtet kur ishte bërë një çështje faktike dhe ishte marrë premtimi prej banorit të pallatit, z. H.Sh., si ndërtues i shtesës, për ndarjen e sipërfaqes shtesë ndërtimore, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të këtij viti se me kërkesë nga banorët, kishte filluar procedura e legalizimit të ALUIZNI dhe se pagesa për pjesën e tij me sip. 85 m<sup>2</sup> nuk ishte kryer ende, për arsye se do të paguhej në vitin 2011, siç edhe ka ndodhur në fakt.

65. Subjekti shpjegon se e drejta e fituar nga bashkëshorti mbi shtesën e katit nuk buron nga ndërtimi prej tij i kësaj shtese, por nga negocimi dhe marrëveshja me personin që e kreu realisht ndërtimin, z. H.Sh. Subjekti i bashkëlidh pyetësorit marrëveshjen mbi pronësinë e ndërtimit në proces legalizimi në datën 22.9.2011, midis shtetasve H.Sh., dhe S.S., sipas së cilës z. H.Sh., deklaroi se ka ndërtuar dhe ka aplikuar për legalizim të një ndërtimi shtesë kati, si dhe se i njeh dhe i pranon të drejtat e z. S.S., që burojnë nga bashkëpronësia e detyrueshme. Nga informacioni në sistemin *TIMS*, duket se z. H.Sh., ka qenë në Shqipëri në datën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje. Sipas kësaj marrëveshjeje, kur ndërtimi ka përfunduar, z. H.Sh., merr përsipër t'i njohë të drejtën e pronësisë z. S.S., mbi ½ e sipërfaqes ndërtimore dhe ta paraqesë këtë marrëveshje tek ALUZINI me qëllim finalizimin e procedurës, ndërsa z. S.S., merr përsipër t'i paguajë deri në fund të dhjetorit 2011, z. H.Sh., vlerën e punimeve të kryera sipas preventivit.

66. **Mbi vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë**, të deklaruar si të shpenzuar, subjekti shpjegon se në vitin 2011, kur procedurat kishin avancuar dhe po shkohej drejt përfundimit, u krye edhe pagesa e përcaktuar në situacionin e punimeve, pagesë e cila iu dha z. H.Sh., që kishte përballuar të gjithë koston e ndërtimit. Subjekti i rivlerësimit sqaron se sipas kushteve të marrëveshjes dhe planimetrisë së ndarjes së shtesës së katit u finalizua procedura me lëshimin e lejes së legalizimit, duke evidentuar në planimetrinë përkatëse edhe pronarin përfitues për secilën sipërfaqe. Subjekti vijon më tej se po në vitin 2011, u krye edhe një pagesë prej 360.000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh për blerjen e disa mobiljeve bazë për apartamentin, për të cilin nuk u pa e arsyeshme për ta mobiluar tërësisht, pasi ishte e paqartë se përse do të përdorej dhe në fakt, për një periudhë të gjatë mbeti i papërdorur.

67. Vlera prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh shpjegohet edhe në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, të përpiluar nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2014, ku në f. 4, numërtori 21 është deklaruar si pagesë e kryer në vitin 2011 “për ndërtim dhe mobilim”. Edhe në deklaratën “Vetting”, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezulton se ka deklaruar që vlera prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh përbëhet nga 1.638.095 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë, si vlera e ndërtimit dhe diferenca prej rreth 360.000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, si vlerë mobiliimi, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës.

68. Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>17</sup> vendos në dispozicion fotokopjen e formularit të vetëdeklarimit në lidhje me shtetasin S.S. Ky dokument nuk është i lexueshëm qartësisht. Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>18</sup>, gjithashtu, dërgon urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t nr. \*\*\*, datë 1.4.2010, “Për përfshirje në bazën digjitale të të dhënave të treguesve të pasurisë së vetëdeklaruar, 5 shtetas, ndër të cilët edhe shtetasi S.S”. Sipas këtij urdhri, shtetasit e mësipërm janë zotërues të shtesës së katit. Nga dokumentacioni rezulton se sipërfaqja totale e objektit të z. S.S., është 84.4 m<sup>2</sup>.

69. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.12.2019 Agjencia Shtetërore e Kadastrës informon se formulari për aplikim (vetëdeklarimi, vështirësisht i lexueshëm) është nënshkruar nga z. A.P., (origjinali). Një kopje e këtij formulari gjendet edhe në dosjen e z. S. M. S. Sipas shkresës së ASHK-së, bazuar në nenin 36/1 të ligjit nr. 9482, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”,

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2019.

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2019.

citohet: “Në rastin e objekteve me leje ndërtimi apo të ngritura përpara vitit 1993, tek të cilat janë kryer shtesa anësore dhe/ose shtesa kati, përfshirja e legalizimit të subjekteve poseduese të tyre bëhet me kërkesë, me kushtin që njëri nga subjektet poseduese të ketë aplikuar për legalizim në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj”. Në këto kushte, z. S.S., është pajisur me leje legalizimi duke u bazuar në vetëdeklarimin e z. A.P., dhe urdhërpërfshirjen në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve. Nga kopja e vetëdeklarimit të vendosur në dispozicion nga ASHK-ja rezulton se z. A.P., e ka bërë vetëdeklarimin më 15.10.2006. Leja e legalizimit të z. A.P., së bashku me dy shtetas të tjerë, ka dalë në vitin 2010.

70. Sipas kontratës nr. \*\*\*, janar 2017, z. S.S., këtë pasuri ia jep me qira shtetasit G.A.Ch., për një periudhë 1-vjeçare, përkatësisht 16 maj 2016 - 16 maj 2017, kundrejt vlerës 550 (pesëqind e pesëdhjetë) euro/muaj. Pagesa e qirasë bëhet nëpërmjet bankës, në llogarinë e subjektit.

71. Subjekti, e pyetur në lidhje me përfitimin e kësaj qiraje, si dhe mbi pagimin e detyrimeve tatimore, sqaron<sup>19</sup> se tatimi mbi qiranë është paguar nga bashkëshorti në datën 27.4.2017, në vlerën 66.939 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) lekë, nëpërmjet llogarisë së tij bankare, pasi ka kryer deklarimin DIVA për vitin 2016, pranë organeve tatimore. Subjekti ka paraqitur kopje të kësaj deklarate, ku evidentohet deklarimi i vlerës së qirasë, së përfutur gjatë vitit 2016<sup>20</sup>, si dhe kopje të ekstraktit të llogarisë bankare<sup>21</sup>, ku evidentohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat individuale.

72. Në përfundim të hetimit, lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton:

- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, z. S.S., deklaroi kërkesë për legalizim nga banorët e pallatit, pjesa takuese sip. 85 m<sup>2</sup>, pagesa e caktuar për t’u paguar në vitin 2011;
- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, ai deklaroi vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë shpenzime “mobilim shtëpi banimi për vitin 2011”, e cila korrespondon me vitin e legalizimit të objektit dhe marrëveshjes me z. H.Sh.;
- në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 ai deklaroi vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë shpenzime për pagesën e kryer për ndërtim dhe mobilim të apartamentit të legalizuar në vitin 2011 dhe të deklaruar që në vitin 2010;
- në deklarimin “Vetting” ai deklaroi shpenzime në vlerën 1.638.095 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë e pesë) lekë, për shtesën apartament banimi me sip. 81,69 m<sup>2</sup>, e cila përkon me aktmarrëveshjen dhe situacionin e punimeve.

Nisur nga fakti se mes deklarimeve veting dhe atyre periodike të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dukej që kishte një mospërputhje lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e apartamentit dhe vlerën e shpenzuar për arredimin e tij në v.2011, subjektit iu kërkuar të jepte shpjegime për këtë pasaktësi.

73. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se: “Është i vërtetë fakti i konstatuar për një paqartësi mbi destinacionin e përdorimit të kësaj vlere, referuar mënyrës se si është shkruar fillimisht në deklarimin periodik vjetor për vitin 2011, e saktësuar më pas në deklarimin përpara fillimit të detyrës (viti 2014), si dhe në deklaratën ‘Vetting’”.

Referuar deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2014, ku është reflektuar ‘si pagesë e kryer për ndërtim dhe mobilim vlere 2.000.000 (dy milionë) lekë’, si dhe deklarates ‘Vetting’, në të cilën bashkëshorti im ka bërë një deklarim më të detajuar të vlerës prej 2.000.000 (dy milionë) lekësh, e shpenzuar, si për punimet e ndërtimit të kryer (vlere 1.638.095 lekë, referuar situacionit të punimeve), ashtu edhe për mobilim.

<sup>19</sup> Pyetësori nr. 2, përgjigjja nr. 2, pika h.

<sup>20</sup> 550 qira mujore bruto \* 6 muaj \* kursi i këmbimit = 446.259 lekë.

<sup>21</sup> Llogaria nr. \*\*\*, në lekë, në “Credins Bank”, kryer pagesa në vlerën 66,939 lekë, datë 27.4.2017.

*Deklarata periodike vjetore e vitit 2011 përmban një përshkrim jo aq korrekt të destinacionit të vlerës së mësipërme, për shkak të shënimit 'mobilim shtëpi banimi për vitin 2011'. Nëse analizohet kjo shprehje, në raport edhe me deklarimin periodik të një viti më parë (2010), mbi detyrimin monetar kundrejt z. H.Sh., i cili do të përmbushej në vitin 2011 (siç edhe ka ndodhur), si dhe me deklarimet e mëpasshme para ILDKPKI-së për të njëjtin fakt, del qartë se vlera u pagua, si për punimet e ndërtimit që ishin kryer nga banori, ashtu edhe për blerjen e disa mobiljeve.*

*Për shkak të kësaj pasaktësie të konstatuar prej bashkëshortit, me qëllim pasqyrimin sa më korrekt të këtij zëri, është reflektuar më pas, kur ai ka përpiluar deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, dhe, për më tepër, kur të dy së bashku kemi përpiluar deklaratën 'Vetting', duke e shmangur këtë paqartësi, krejtësisht të paqëllimshme."*

74. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se nuk ka dyshime lidhur me to. Referuar të dhënave të deklarimeve periodike të viteve 2010 dhe 2011, si dhe të deklaratës përpara fillimit të detyrës së vitit 2014, të vlerësuara në tërësi dhe harmoni me njëra-tjetrën, por edhe në raport me Deklaratën Veting, vërtetohet se destinacioni i përdorimit të shumës 2.000.000 lekë ka qenë për pagesën e punimeve të ndërtimit në vlerën 1.638.095 lekë (në përputhje me situacionin e punimeve), ndërsa pjesa tjetër për mobilimin e banesës.

Deklarimi i destinacionit të përdorimit të kësaj shume nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklarimin periodik vjetor të vitit 2011, vlerësohet të mos jetë i qartë në raport me deklarimet e tij ndër vite, para dhe mbas këtij deklarimi, paqartësi kjo që nuk rezulton të jetë bërë në mënyrë të qëllimshme, prandaj, si e tillë, nuk mund të shërbejë për të pranuar të kundërtën e asaj që rezulton në fakt nga deklarimet në tërësi të tij, pra, për t'i dhënë këtij deklarimi një vlerë të paracaktuar dhe më të fortë provuese në raport me deklarimet e të njëjtit lloj dhe atij Vetting.

**75. Truall me sip. 285 m<sup>2</sup>, nga e cila 51 m<sup>2</sup> ndërtesë, me vendndodhje në lagjen "\*\*\*\*", Vlorë.** Kjo pasuri është përfituar nga bashkëshorti i subjektit në bashkëpronësi me fëmijët E., dhe K. S., fituar sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, vendim datë 9.9.2002, përpara martesë, dhe e ka origjinën nga ish-bashkëshortja e z. S.S., e cila e ka fituar nga prindërit e saj.

76. ZVRPP-ja Vlorë<sup>22</sup> informon se në emër të shtetasve S.S., E.S., dhe K.S., janë regjistruar pasuritë me të dhënat, si më poshtë:

- pasuria "garazh" me sip. 39 m<sup>2</sup>, në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë;
- pasuria "apartament banimi" me sip. 111 m<sup>2</sup>, në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë;
- pasuria "apartament banimi" me sip. 66 m<sup>2</sup>, në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë;
- pasuria "apartament banimi" me sip. 90 m<sup>2</sup>, në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë;
- pasuria "apartament banimi" me sip. 63 m<sup>2</sup>, në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë;
- pasuria "apartament banimi" me sip. 89 m<sup>2</sup>, në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë;
- pasuria "njësi" me sip. 86.5 m<sup>2</sup> është e regjistruar në favor të shtetasve S.S., E.S., K.S., me zotërim 55 % ose 11/20 pjesë dhe shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., me zotërim 45 % ose 9/20 pjesë.

Pasuritë e mësipërme janë fituar sipas kontratës së këmbimit truall me apartamente, njësi shërbimi dhe garazh, nr. \*\*\*, datë 17.5.2017. Shtetasit S.S., E.S., K.S., kanë në bashkëpronësi truallin me sip. 300 m<sup>2</sup> në<sup>23</sup> Vlorë, mbi të cilin është ndërtesa me sip. 51 m<sup>2</sup>. Pronarët i kanë vendosur këto pasuri në dispozicion të shoqërisë "\*\*\*\*" për ndërtimin e një objekti shumëkatësh.

77. Me vendim të KRRT-së nr. \*\*\*, datë 28.9.2011, shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., i miratohet leja e ndërtimit për godinë banimi dhe shërbimi 9 kate, kati përdhes dyqane, 1 kat parkim nëntokë në lagjen "\*\*\*\*" Vlorë.

<sup>22</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2018, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>23</sup>Me urdhrin e brendshëm nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2011, të regjistruesit të ZVRPP-së Vlorë është bërë korrigjimi i sipërfaqes në kartelën e pasurisë nga 300 m<sup>2</sup> në 285 m<sup>2</sup>.

78. Përpara kontratës së shkëmbimit të datës nr. \*\*\*, datë 17.5.2017, midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe pronarëve të truallit S.S., E.S., dhe K.S., janë nëshkruar kontratat, si më poshtë:

1. Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 6.10.2010, ku bashkëshorti i subjektit dhe dy fëmijët e tij<sup>24</sup> vendosin në dispozicion të palës sipërmarrëse, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., truallin me sip. 285 m<sup>2</sup> <sup>25</sup>, mbi të cilin ka një ndërtim prej 51 m<sup>2</sup> në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, për ndërtimin e një ndërtese shumëfunktionale. Sipas kontratës, pronarët do të marrin 31% të sipërfaqes së ndërtimit që do të realizohet.

2. Kontratën e sipërmarrjes (shtesë) nr. \*\*\* rep., datë 11.6.2012, ku bashkëshorti i subjektit dhe dy fëmijët e tij, për shkak të vendosjes në dispozicion të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të truallit me sip. 285 m<sup>2</sup>, mbi të cilin ka një ndërtim prej 51 m<sup>2</sup> në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë do të përfitojnë: një kat parkim me sip. 47 m<sup>2</sup>, kati teknik, njësi shërbimi me sip. 47 m<sup>2</sup>, kati i gjashtë banim me sip. 66 m<sup>2</sup>, kati i gjashtë banim me sip. 90 m<sup>2</sup>, kati i gjashtë banim me sip. 89 m<sup>2</sup>, kati i gjashtë banim me sip. 63 m<sup>2</sup>, kati i gjashtë banim me sip. 111 m<sup>2</sup>.

79. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, z. S.S., ka deklaruar në cilësinë e personit të lidhur kontratë sipërmarrjeje dhe shtesën e saj me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke specifikuar njësitë përkatëse (shërbimi dhe banimi) të përfituara nga këto kontrata, si dhe ka deklaruar 100 % pjesë takuese mbi këto njësi.

80. Bazuar në kontratat e lidhura ndërmjet z. S.S., dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., u llogarit përqindja e përfituar prej tij dhe fëmijëve, sipas tabelës së mëposhtme:

| Llogaritjet e ndërtimit Vlorë                              | m <sup>2</sup> | Përqindja |
|--|----------------|-----------|
| Sipërfaqe sheshi   | 1.355          |           |
| Sipërfaqe bashkëshorti i subjektit                         | 285            | 21%       |
| Sipërfaqe ndërtimi (njolla) sipas vendimit të KRT-së Vlorë | 804            |           |
| Ndërtim total (10 kate – 9 mbi tokë dhe 1 nën tokë)        | 8.040          |           |
| Ndërtim mbi pjesën e bashkëshortit të subjektit            | 1.691,1        |           |
| Pjesa takuese 31 %   | 524,2          |           |
| <b>Ka marrë:</b>   | 513            |           |

81. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit mbi kohën kur ka përfunduar ndërtimi i pasurive të sipërcituara, kohën kur i ka marrë bashkëshorti i saj në përdorim, si dhe mbi përdorimin aktual të tyre. Gjithashtu, Komisioni kërkoi librezën e energjisë elektrike apo çdolloj dokumentacioni tjetër provues për pagesën e energjisë elektrike për këto pasuri.

82. Me përgjigjet e pyetësorit të datës 9 janar 2020 subjekti, ndër të tjera, sqaron se: “ (i)... ndërtimi i pallatit, ku ndodhen pasuritë e përfituara nga bashkëshorti dhe fëmijët, ka përfunduar nga fillimi i vitit 2016, ndërkohë që përfundimi i sistemimit të jashtëm dhe akti i kolaudimit është realizuar përgjatë vitit 2016, ndërsa certifikata e përdorimit është dhënë nga bashkia në janar të vitit 2017; (ii) në shkurt të vitit 2016, shoqëria ndërtuese i dorëzoi fizikisht bashkëshortit dhe fëmijëve të tij, sipërfaqet ndërtimore të apartamenteve të përfituara; (iii) që në shkurt të vitit 2016 u lidhën edhe kontratat për furnizimin me energji elektrike për apartamentet. Nga koha e marrjes në dorëzim e aktualisht, vetëm njëri nga apartamentet e përfituara, me nr. \*\*\*, të kontratës së OSHEE-së është përdorur nga bashkëshorti, fëmijët dhe familja; (iv) sqaroj se edhe për apartamentet që nuk përdoren nga marrja e tyre në dorëzim, janë lidhur kontratat e energjisë elektrike me OSHEE-në, respektivisht me nr. \*\*\*; nr. \*\*\*; nr. \*\*\*, për të cilat është paguar rregullisht tarifa fikse për shërbimin në vlerën 340 (treqind e dyzet) lekë në muaj. Kopjet e librezave të tyre, si dhe një

<sup>24</sup> Me vendimin nr. \*\*\* i lëshohet autorizimi z. S.S., për tjetërsimin e pjesës takuese të fëmijës së mitur, K.S., të pasurisë me sip. 285 m<sup>2</sup> të llojit truall, mbi të cilin ka një ndërtim prej 51 m<sup>2</sup> në lagjen “\*\*\*\*”, Vlorë, ku fëmija i mitur është bashkëpronar me 13 pjesë të kësaj pasurie.

<sup>25</sup> Me urdhrin nr.\*\*\* prot., datë 4.1.2011, të regjistruarit të ZVRPP-së Vlorë, është bërë korigjimi i sipërfaqes në kartelën e pasurisë nga 300 m<sup>2</sup> në 285 m<sup>2</sup>.

informacion nga sistemi i të dhënave të OSHEE-së, i gjeni bashkëlidhur; (v) për sa i përket njësisë, e cila është në bashkëpronësi me shoqërinë ndërtuese ‘\*\*\*’, sh.p.k., kontrata e furnizimit me energji me nr. \*\*\*, sikurse kontratat e tjera, është lidhur në shkurt të vitit 2016. Sqaroj se kjo njësi, e ndodhur në katin 0, nuk është marrë asnjëherë në zotërim, edhe për shkak të bashkëpronësisë, por edhe për faktin se nuk është përdorur asnjëherë nga bashkëpronarët apo ndonjë i tretë dhe kjo konfirmohet nga librezja, por edhe nga sistemi i të dhënave të OSHEE-së, nga të cilat rezulton se pagesa e kryer për energjinë elektrike në këtë njësi është vetëm për tarifën fikse të shërbimit; (vi) lidhur me garazhin, sqaroj se nuk furnizohet me energji, me kontratë të veçantë”.

83. Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie nga znj. E. S., e cila shpjegoi se babai, z. K.Gj., e ka blerë në vitin 1970, nga shitësja M.P., truallin me sip. 300 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 2.300 (dy mijë e treqind) lekë, veprim i cili është kryer me shkresë të thjeshtë. Në vitin 1972, z. K.Gj., ka ndërtuar mbi truallin e blerë prej tij, një banesë. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.2.1973, Gjykata Popullore e Vlorës vërteton faktin juridik se kërkuesi K.Gj., është pronar i një shtëpie. Z. K.Gj., ka ndërruar jetë më 25.1.1990 dhe sipas dëshmisë së trashëgimisë së datës 21.6.1990 përcaktohen si trashëgimtare ligjore të radhës së parë, bashkëshortja P., dhe e bija E.Gj.

Me kontratën e dhurimit nr. \*\*\* rep., të datës 27.1.1993, znj. P.Gj., i dhuroi së bijës, E. Gj., pjesën e saj ideale prej 1/2 mbi këtë pasuri të trashëguar. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.9.1995, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë pranoi padinë e znj. E. S., për fitimin e pronësisë mbi truallin ku ngrihej banesa me parashtrim fitues.

84. Komisioni i kërkoi informacion Gjykatës Kushtetuese mbi çështje gjyqësore të shqyrtuara në periudhën 1998 – 2011, me palë shoqërinë “\*\*\*\*” ose ortakët e saj. Gjykata Kushtetuese<sup>26</sup> informon se nuk rezulton asnjë çështje, ku subjektet e sipërcituar të kenë qenë palë ndërgjyqëse.

85. Nga hetimi nuk u konstatuan problematika lidhur me këto pasuri.

**86. Apartament banimi me sip. 99.5 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Qerret, Kavajë,** blerë sipas kontratës datë 5.9.2006, në vlerën 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro. Burim krijimi: nga shitja e një apartamenti<sup>27</sup> dhe nga të ardhurat.

87. ZVRPP-ja Kavajë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2019, konfirmon se në emër të z. S. S., dhe të subjektit të rivlerësimit rezulton e regjistruar pasuria apartament me nr. \*\*\*, me sip. 99.5 m<sup>2</sup> në Qerret, Kavajë.

Te kartela e pasurisë apartament është vendosur në seksionin D përshkrimi “apartamenti ndodhet mbi ndërtesën \*\*\* ndërtesë, e cila ndodhet mbi truallin 1/247, regjistruar kontrata e shitjes së truallit midis ALUIZNI-t dhe z. S.S., për sip. 58.56 m<sup>2</sup>”.

88. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 1.5.2012, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., i shet z. S.S., apartament banimin me sip. 99.5 m<sup>2</sup>, në vlerën 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, me vendndodhje në Qerret, Kavajë. Palët deklarojnë se likuidimi i vlerës prej 58.750 euro (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) është bërë jashtë zyrës noteriale.

89. Për shkak se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ishte mbajtës/titullar i të drejtës reale mbi apartamentin, përfitoi edhe të drejtën e blerjes së truallit nën të (së bashku me bashkëpronarët e tjerë të pallatit ku ndodhet apartamenti), bazuar në ligjin nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”. Truallin me sip. 710.27 m<sup>2</sup>, që i përket apartamentit të sipërcituar në bashkëpronësi me të tjerë, z. S.S., e ka përfutur

<sup>26</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 26.12.2019.

<sup>27</sup> Ap. me sip. 86.5 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Kavajë, sipas certifikatës për vërtetimin pronësie të datës 31.1.2003 është regjistruar në emër të z. S.S.

me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 1.12.2011, “Për kalimin e së drejtës së pronësisë së truallit” nga ALUIZNI, kundrejt vlerës 65.442 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dyzet e dy) lekë<sup>28</sup>.

90. Me kontratën e datës 5.9.2006, bashkëshorti i subjektit porositi shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., të ndërtojë dhe t’i dorëzojë apartamentin me sipërfaqe ndërtimi 99.5 m<sup>2</sup> kundrejt vlerës 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, e cila është paguar menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

91. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, z. S.S., deklaroi kontratë sipërmarrjeje datë 5.9.2006, për ndërtimin e një apartamenti me sip. 99.5 m<sup>2</sup>, në Qerret<sup>29</sup> me çmimin 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, e cila është e pargjistruar ende në ZVRPP-në Kavajë, nga sipërmarrësi dhe nuk është përpiluar kontrata e shitjes. Si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti z. S.S., deklaroi: (a) shitjen e apartamentit me sip. 86.5 m<sup>2</sup><sup>30</sup>, me adresë \*\*\*, Kavajë; (b) të ardhurat.

Subjekti shpjegon se para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes së datës 5.9.2006 palët kanë negociuar për kushtet dhe ndërkohë që kryeshin punimet janë paguar herë pas here, edhe pjesë të çmimit të rënë dakord<sup>31</sup>. Subjekti shprehet se nuk ka ruajtur gjithë mandatarkëtimet, por vetëm ato, si më poshtë: (1) mandatarkëtim, datë 24.4.2006, në vlerën 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro; (2) mandatarkëtim, datë 19.7.2006, në vlerën 13.000 (trembëdhjetë mijë) euro; (3) mandatarkëtim, datë 4.9.2006, në vlerën 7.000 (shtatë mijë) euro.

Në pyetësorin standard subjekti deklaroi për mobilim vlerën prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh, si dhe shprehet se kjo banesë nuk përdoret rregullisht gjatë gjithë vitit, përveç muajve të verës.

92. Komisioni i kërkoi informacion Gjykatës Kushtetuese mbi çështje gjyqësore të shqyrtuara në periudhën 1998 – 2011 me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., ose ortakët e saj dhe nuk rezultoi ndonjë çështje e shqyrtuar nga z. S.S.

93. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, z. S.S., deklaroi shitjen e apartamentit me sip. 86.3 m<sup>2</sup>, që ndodhet në \*\*\* dhe i regjistruar në ZVRPP-në Kavajë, z. M.M., në vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro. Kontrata e shitjes është e pargjistruar për shkak të kolateralit për arsye kredie, vërtetuar pranë noterit, veprim i kryer me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 4.12.2016. Në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 4.12.2006, z. M.M., deklaroi se ka rënë dakord me z. S.S., për të blerë apartamentin me sip. 86.5 m<sup>2</sup> në \*\*\*, në vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro. Këtë vlerë z. S.S., do ta përdorte për të blerë apartamentin në Qerret. Z. M.M., deklaroi se nuk është redaktuar kontrata e shitjes, pasi kjo pronë është vënë si kolateral nga z. S.S., në favor të “Bankës Kombëtare të Greqisë”. Sipas deklaratës noteriale z. M.M., e ka marrë në dorëzim apartamentin para se të kryhen procedurat e shitjes. Subjekti shpjegon se pagesa e parave nga z. M.M., është kryer në dorë, ndaj edhe pasqyrimi i saj u bë nëpërmjet rrugës noteriale, si më e sigurt mes dy personave fizikë. Subjekti bashkëlidh deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 21.3.2006, ku z. S.S., deklaroi se është pronar i një apartamenti banimi të ndodhur në Golem, me sip. 86.5 m<sup>2</sup>, për të cilin është rënë dakord t’ia shesë z. M.M., kundrejt vlerës 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro dhe se apartamenti në gjendjen që është deklaruar i mobiluar i është dorëzuar z. M.M., që i ka paguar shumën e çmimit të shitjes prej 55.000 euro

Në seksionin E të kartelës së pasurisë, në datën 25.2.2003 është regjistruar hipoteka në favor të “Bankës Kombëtare të Greqisë”, vlera e kredisë 20.000 (njëzet mijë) USD. Kjo hipotekë është fshirë më 15.5.2008.

<sup>28</sup>Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kaluar nëpërmjet “Credins Bank” pagesën për truallin.

<sup>29</sup> Apartamenti ndodhet në Qerret, Kavajë.

<sup>30</sup> Ky apartament blihet nga shtetasi Z.E.

<sup>31</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 30.8.2017.

94. Ky apartament është blerë nga z. S.S., me kontratën e shitjes së pasurisë nr. \*\*\*, datë 29.1.2003, nga shtetasi Z.E., në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë. Sipas kontratës, palët deklarojnë se likuidimet i kanë shlyer dhe nuk kanë detyrim ndaj njëri-tjetrit.

Me kontratën e datës 24.2.2003, z. S.S., merr kredi nga “Banka Kombëtare e Greqisë”, vlerën 20.000 (njëzet mijë) USD me qëllim blerjen e apartamentit në Golem, Kavajë. Sipas kontratës, kredimarrësi merr përsipër detyrimin për të bërë regjistrimin hipotekor në favor të bankës pranë ZVRPP-së Kavajë. Sipas vërtetimit të datës 16.10.2016, të “Bankës Kombëtare të Greqisë”, z. S.S., i është *disbursuar* kredia për shtëpi në vlerën 20.000 (njëzet mijë) euro, në datën 28.2.2003 dhe është likuiduar totalisht më 29.4.2008.

Subjekti deklaron se z. S.S., kërkoi marrjen e kredisë bankare për kryerjen e punimeve të brendshme, të cilat nuk ishin kryer nga shoqëria, si dhe një pjesë e saj u përdor edhe për mobilimin.

Komisioni i është drejtuar me shkresë bankës “ABI”, duke kërkuar dosjen e plotë të kredisë. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2019, “ABI” dërgon kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 24.3.2003 (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke), shoqëruar me vërtetimin e nënshkrimit nr. \*\*\*, datë 24.2.2003, sipas së cilës z. S.S., merr kredinë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) USD me qëllim blerjen e apartamentit në \*\*\*, Kavajë. Nga kontrata e kredisë rezulton se kredimarrësi merr përsipër detyrimin për të bërë regjistrimin hipotekor të këtij apartamenti në favor të bankës. Banka vendos në dispozicion të gjitha lëvizjet në llogarinë e kredisë, që nga *disbursimi*, pagesat mujore të ndara në principale dhe interesa, si dhe shlyerjen e kredisë.

Komisioni e pyeti subjektin mbi arsyen e marrjes së kredisë nga bashkëshorti të vlerës prej 20.000 (njëzet mijë) USD, ndërkohë që apartamenti kushtonte 1.000.000 (një milion) lekë. Subjekti shpjegon se akordimi i kredisë është një çështje që lidhet me politikën e bankës. Në rastin konkret, banka ka marrë në konsideratë edhe vlerën që në të ardhmen do t’i shtohet apartamentit, pas investimit të vlerës së kredisë, me përfundimin e punimeve të ndërtimit, sikurse ndodhi në fakt.

Subjekti bashkëlidh përgjigjen e bankës “ABI” nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2019, sipas së cilës, nisur nga procedurat standarde që ish-Banka Kombëtare e Greqisë aplikonte në vitin 2003, kryente një analizë financiare të kredikërkuarit dhe pasurisë që ofrohej si kolateral. Gjithashtu, sipas shkresës së bankës janë marrë në konsideratë edhe rrethanat personale të kredimarrësit funksioni dhe të ardhurat e tij. Komisioni konstatoi se diferenca mes çmimit të blerjes 1.000.000 (një milion) lekë në vitin 2003 dhe çmimit të shitjes 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, në vitin 2006 është e lartë dhe për këtë pyeti subjektin, i cili deklaroi se ky çmim i referohet disa rrethanave, për shkak të të cilave edhe apartamentet e tjera në të njëjtin pallat u shitën me çmim të tillë.

Subjekti bashkëlidh kontratën e shitjes, send i paluajtshëm nr. \*\*\*, datë 10.3.2003, ku z. Z. E., i shtetstasi L.L., njësinë me sip. 140 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, si dhe kontratën e shitjes së datës 18.2.2002, ku shtetasi Z.E., i shtetstasi F.V., apartamentin me sip. 55.6 m<sup>2</sup>, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë.

Subjekti jep disa arsye për diferencën ndërmjet çmimit të blerjes dhe çmimit të shitjes, si p.sh.: ndërtimi ku përfshihej apartamenti ndodhej në një zonë që në kohën e blerjes ishte tërësisht e pazhvilluar, pa infrastrukturë, pa rrugë, ujësjellës e kanalizime, ishte pallat i vetëm dhe gjendej në tokë bujqësore, në një terren moçalor dhe jo në pjesën që zënë pishat. Subjekti bashkëlidh foto të zonës.

Gjithashtu, subjekti shpjegon se bashkëshorti me ndërtuesin kanë rënë dakord që në fillim të vitit 2001 për çmimin e apartamentit, pavarësisht se ndërtimi përfundoi kohë më vonë. Subjekti shprehet se vlera prej 1.000.000 (një milion) lekësh përfaqëson vlerën e apartamentit pa punime të brendshme. Sipas deklarimeve të subjektit, për të kryer këto punime dhe për ta mobiluar apartamentin, bashkëshorti ka përdorur kredinë e marrë në “Bankën Kombëtare të Greqisë”.



95. Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstaton:

- a) Në datën 21.3.2006, palët kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., ku z. S.S., deklaron se është pronar i një apartamenti banimi të ndodhur në \*\*\*, Kavajë, me sip. 86.5 m<sup>2</sup>, të cilin ka rënë dakord t'ia shesë z. M.M., kundrejt vlerës 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro. Z. S.S., deklaron se është pranuar nga z. M.M., shlyerja e shumës së mësipërme, njohja atij e të drejtës për të mbajtur në posedim dhe për të gëzuar lirisht pasurinë, si dhe angazhimi për të ndërmarrë në të ardhmen veprimet e nevojshme për çlirimin e pronës nga hipoteka dhe realizimin e kontratës përfundimtare të shitblerjes, sipas ligjit.
- b) Në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 4.12.2006, z. M.M., deklaron se ka rënë dakord me z. S.S., për të blerë apartamentin me sip. 86.5 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Kavajë, në vlerën 55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, vlerë të cilën z. S.S., do ta përdorë për të blerë një shtëpi tjetër në Qerret. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pagesa e vlerës nga z. M.M., është kryer *cash*, ndaj edhe pasqyrimi i saj u bë nëpërmjet rrugës noteriale, si më e sigurta mes dy personave fizikë.
- c) Me kontratën e datës 5.9.2006 bashkëshorti i subjektit nënshkroi kontratën e porosisë me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., për ndërtimin dhe dorëzimin e një apartamenti me sipërfaqe ndërtimi 99.5 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 58,750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, e cila është paguar menjëherë me nënshkrimin e kontratës. Pagesa bëhet pranë arkës së shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. Çmimi i blerjes u caktua në vlerën 58.750 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro, i cili në momentin e lidhjes së kontratës (datë 5.9.2006), ishte paguar në arkën e shoqërisë shitëse, sikurse përcaktohet edhe në përmbajtjen e saj.
- ç) Burimi i deklaruar për blerjen e kësaj pasurie janë nga shitja e apartamentit në Golem, Kavajë dhe të ardhurat e tij.

96. Në situatën e mospërputhjes mes momentit të marrjes së parave nga z. M.M., në datën 4.12.2006 dhe derdhjes së tyre tek shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. deri në datën 4.9.2006, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime për këto mospërputhje dhe burimin e ligjshëm të shumës.

97. Në shpjegimet e tij, subjekti sqaroi se: *“Nga analiza e akteve shkresore të administruara, ashtu sikurse kam dhënë sqarime edhe më parë kur jam pyetur nga ju, lidhur me këto fakte, më lejoni të sqaroj se paratë për blerjen nga ana e z. M.M., të apartamentit, që bashkëshorti im kishte në pronësi, ishin paguar në momentin kur bashkëshorti nënshkroi deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., datë 21.3.2006. Ky është momenti kur palët ishin dakordësuar për të gjitha kushtet e shitjes dhe nëse sendi nuk do të kishte qenë i vendosur në hipotekë në favor të ‘Bankës Kombëtare të Greqisë’, do të ishte realizuar edhe kontrata për kalimin e së drejtës së pronësisë. Për këtë shkak, z. S. S., në cilësinë e shitësit, i kaloi blerësit posedimin mbi sendin, ndërsa mori vlerën e çmimit, për të cilin ishte rënë dakord. Pagimi i kësaj vlere, si një detyrim i blerësit, nuk mund të vërtetohej me kontratë shitjeje, e cila nuk mund të lidhej për arsyen e lartpërmendur. Prandaj, sipas dispozitave të Kodit Civil shitësi duhej t’i lëshonte blerësit një dëftesë (shkresë) për të konfirmuar faktin e përmbushjes së detyrimit nga blerësi. Pikërisht, kjo është bërë në mars të vitit 2003, kur u pagua çmimi i apartamentit.*

*Për sa i përket deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., datë 4.12.2006, nënshkruar nga z. M.M., (e cila edhe mund të mos ishte kryer), sqaroj se ka qenë kërkesë e bashkëshortit tim si subjekt deklarues, që të kishte edhe ai një deklaram nga personi, të cilit ia kishte shitur banesën dhe nga i cili kishte marrë paratë. Për këtë arsye i ka kërkuar z. M.M., që të bëjë këtë deklaram para noterit, (tashmë në muajin dhjetor). Z. M.M., është paraqitur personalisht dhe ka bërë deklaramin që ka parë të arsyeshëm, duke përfshirë këtu jo vetëm faktin se i kishte paguar paratë për blerjen e apartamentit, por edhe se këtë vlerë z. S.S., do ta përdorte për të blerë një tjetër apartament. Për më tepër që në këtë deklaram vetë z.M.M., e pranon se ‘apartamentin e mësipërm unë e kam marrë në dorëzim para se të kryhen procedurat e shitjes’.*

Është e kuptueshme se në kohën e këtij deklarami (dhjetor 2006), z. M.M., nuk ka qenë në dijeni të zhvillimeve për marrëdhëniet financiare dhe kryerjen e pagesave mes bashkëshortit tim dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., ndaj ai ka deklaruar atë që ka ndodhur që në muajin mars 2006, kur në fakt i pagoi paratë dhe mori apartamentin në dorëzim. Lidhur me këtë, ne i kërkuam edhe aktualisht z. M.M., të deklarojë mbi këto fakte dhe ai pa hezitim e bëri një gjë të tillë<sup>32</sup>, sikurse është i gatshëm të vijë edhe për të dëshmuar.

Në përfundim të kësaj çështjeje, do të doja të sillja edhe një herë në vëmendje se veprimet e mësipërme, të kryera nga bashkëshorti im, i përkasin periudhës para martesës sonë. Si të tilla, pavarësisht se sikurse u shpjegua ato janë të ligjshme, vlerësoj se nuk duhet të përfshihen në kuadër të rivlerësimit tim”.

97.1 Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka insistuar në faktin se veprimet e mësipërme të kryera nga bashkëshorti, i përkasin periudhës para martesës, fakt për të cilin ka shpjeguar se bazuar në nenin 11.1 të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, me blerjen e truallit, subjektit të interesuar i lindte e drejta e regjistrimit të kontratës për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi ndërtimin, lidhur mes tij dhe personit të stimuluar. Mbi këtë bazë, u krye edhe regjistrimi i pasurisë në regjistrat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë. Me atë rast, subjekti shpjegon: “Kjo zyrë, kryesisht, ka kërkuar si dokument edhe certifikatën e përbërjes familjare dhe duke qenë se pas gushtit të vitit 2010, figuroja si bashkëshorte e z. S., e regjistroi pronën në bashkëpronësi të të dyve. Gjithsesi, në kuptim të ligjit, e drejta e pronësisë që rezulton në regjistrat e pasurive të paluajtshme edhe në emrin tim, në fakt, vlerësoj se nuk ekziston për këto arsye:

- a) Ligji i zbatueshëm, në rastin konkret, është Kodi i Familjes dhe dispozitat e tij mbi bashkësinë ligjore (regjimi pasuror martesor sipas ligjit). Në parim, Kodi i Familjes përcakton se çdo pasuri e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës, i nënshtrohet regjimit të bashkësisë ligjore (neni 74 i Kodit të Familjes), përfshirë këtu edhe të ardhurat e secilit bashkëshort, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë (germa ‘b’ e nenit 74). Nga ana tjetër, Kodi i Familjes përcakton edhe kuptimin e asaj pasurie që nuk i përket bashkësisë dhe që konsiderohet si ‘pasuri vetjake’. Si e tillë, në germën ‘a’, të nenit 77, përcaktohet edhe ‘pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi’, si dhe në germën ‘dh’ përcaktohet si e tillë edhe ‘pasuria e fituar nga tjetërsimi i pasurive vetjake të sipërpërmendura’. Po ashtu, Kodi i Familjes përcakton edhe mënyrën e administrimit të bashkësisë, si dhe të pasurisë vetjake, duke përcaktuar për këtë të fundit, në nenin 95: ‘Secili bashkëshort ka të drejtë të administrojë dhe të disponojë lirisht pasuritë vetjake’.
- b) Zbatimi i ligjit në rastin konkret, të çon në përfundimin se unë nuk disponoj të drejta reale mbi apartamentin, pasi e drejta e pronësisë i përket vetëm bashkëshortit, i cili ishte titullar i të drejtës reale mbi ndërtimin e blerë prej tij para martesës. Fitimi i së drejtës së pronësisë mbi truallin ku ndodhej ndërtimi, iu njoh me ligj vetëm blerësit të apartamentit si subjekt i interesuar, truall i cili u ble nga bashkëshorti, si titullar i së drejtës reale mbi ndërtimin (shuma e paguar 65,442 lekë), sikurse dhe bashkëpronarët e tjerë të pallatit. Për rrjedhojë, e drejta e pronësisë mbi truallin duhet të konsiderohet si e lidhur ngushtë me mbajtësin e së drejtës reale mbi apartamentin, që ishte ekskluzivisht z. S., dhe jo unë. Pikërisht, me këtë cilësi dhe me të drejtën ekskluzive për të administruar pasurinë e tij vetjake, ai vendosi të blejë truallin nën ndërtim, që nuk ishte një send i mëvetësishëm, ndaj edhe e drejta mbi truallin lidhej ngushtësisht me të drejtën reale mbi ndërtimin. Në këto kushte, për sa kohë që pasuria ‘truall’ nuk ekzistonte më vete, sepse mbi të ndodhej një ndërtim (pasuri vetjake e bashkëshortit), nuk mund të kalonte e drejta e pronësisë mbi të edhe tek unë, që nuk isha subjekt i interesuar, sikurse blerësit e apartamenteve. Ishte vendim personal i bashkëshortit, si titullar i së drejtës

<sup>32</sup> Bashkëlidhur do të gjeni deklaratën notoriale të z. M.M., nr. \*\*\*, datë 18.3.2020.

*reale, që të paguante vlerën e truallit nën ndërtim, në funksion të administrimit të pasurisë që tashmë e kishte blerë. I njëjti qëndrim mbi interpretimin e dispozitave të Kodit të Familjes për pasurinë vetjake, mbahet edhe nga doktrina dhe jurisprudenca, duke konsideruar se vetëm e ardhura e realizuar përgjatë vijimit të martesës, i përket bashkësisë dhe në rastin eventual të përfundimit të saj (bashkësisë), nëse këto të ardhura janë shpenzuar për interesin vetjak të njërit bashkëshort, do të duhet të konsiderohet për të bërë kompensimet e nevojshme, sikurse përcaktohet edhe në nenin 87 të Kodit të Familjes (në rastin konkret bëhet fjalë për shumën 65,442 lekë)”.*

97.2 Mbi sa më lart, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo pasuri, megjithëse është e ligjshme, nuk duhet të përfshihet në kuadër të rivlerësimit të tij.

98. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe përputhen me faktet e rezultuara gjatë hetimit. Pavarësisht se si bashkëpronare mbi këtë pasuri rezultoi të jetë regjistruar edhe subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkak të procedurës së kryer në vitin 2011, për blerjen nga ALUIZNI të truallit në bashkëpronësi mes të gjithë pronarëve të apartamenteve të pallatit, kjo pasuri rezultoi e blerë në vitin 2006 (para martesë) dhe se nuk mund të lidhet me procesin e rivlerësimit të subjektit znj. Edlira Petri.

98.1 Komisioni vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë veç sa ajo ka parashtruar edhe se: (i) sipas nenit 163 të Kodit Civil, e drejta e pronësisë mbi apartamentin në fjalë është fituar më një mënyrë të veçantë të parashikuar në ligjin nr. 10186/2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, i cili kishte si kusht të vetëm për blerjen nga ALUIZNI të truallit nën ndërtim, qenien e blerësit “person i interesuar”, që përkufizohet si subjekti “i cili gëzon njësinë e ndërtuar dhe që ka kryer një veprim juridik të drejtpërdrejtë ose të rrjedhur me personin e stimuluar për kalimin e të drejtave reale mbi njësinë e ndërtuar, të ngritur brenda zonës së stimuluar, përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji” (neni 2/dh). Personi i interesuar në rastin konkret është bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, i cili para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe gjithashtu para martesës, në vitin 2006, kishte kryer një veprim juridik për kalimin e së drejtës reale mbi apartamentin me personin e stimuluar shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. Kjo e drejtë është fituar para martesës dhe konsiderohet si pasuri vetjake në kuptim të Kodit të Familjes; (ii) pikërisht për shkak të kësaj cilësie, dhe ndërkohë që çmimi për gëzimin e së drejtës reale mbi ndërtimin ishte paguar që në vitin 2006, ligji i dha të drejtën bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit që të blinte truallin nën ndërtim; (iii) regjistrimi i së drejtës së pronësisë nga ZVRPP-ja Kavajë në emër të të dy bashkëshortëve, nuk përkon as me të drejtën për fitimin e pronësisë, të lindur sipas ligjit të sipërcituar dhe as me rregullimin ligjor të bashkësisë ligjore. Raporti mes fitimit të së drejtës reale dhe regjistrimit të saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme është trajtuar në Vendimin Unifikues 1/2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimet se: “Pronësia mbi një pasuri të paluajtshme kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi ose përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronar i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës duke fituar dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri” dhe “Sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk ka efekt krijues, por thjesht publikues, njohës, pasi janë aktet bazë mbi të drejtat reale të pronësisë që krijojnë, ndryshojnë apo mbarojnë të drejtat përkatëse dhe jo regjistrimi i akteve”.

98.2 Mbi sa më sipër arrihet në përfundimin se iniciativa e ZVRPP-së Kavajë për të kryer regjistrimin e së drejtës së pronësisë në favor të të dy bashkëshortëve, nuk gjen mbështetje në ligjin mbi bazën e të cilit bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka blerë truallin me kontratën e lidhur me ALUIZNI-n.

98.3 Për rrjedhojë, një regjistrim i tillë nuk mund të ketë efekt krijues të së drejtës në emër të subjektit të rivlerësimit, e për pasojë, përfitimi i kësaj pasurie, si dhe burimi i krijimit të saj nuk duhet të lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit znj. Edlira Petri.

99. Depozitë në “Credins Bank” me gjendje në datën 9.1.2017, në vlerën 23.365 (njëzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) USD. Burim krijimi: të ardhurat. Kjo depozitë ka kaluar nga “Intesa Sanpaolo Bank” te “Credins Bank”. Zotërimi: 100 %.

100. **Depozitë me afat në “Intesa Sanpaolo Bank”,** në vlerën 1.223.472 (një milion e dyqind e njëzet e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) lekë. Zotërimi: 100 %.

101. **Llogari në “Credins Bank”,** me gjendje në datën 9.1.2017, në vlerën 23.487 (njëzet e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë) euro. Burim krijimi: të ardhurat. Zotërimi: 100 %.

102. **Llogari në “Credins Bank”** me gjendje në datën 9.1.2017, në vlerën 3.201.772 (tre milionë e dyqind e një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë. Burim krijimi: të ardhurat. Zotërimi: 100 %.

103. Lidhur me vlerat në depozitat bankare, si dhe me vlerat në llogaritë bankare janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit.

104. Në deklaratat e interesave private periodike vjetore 2003 – 2011, bashkëshorti i subjektit deklaroi me gjeneralitetet S.S., ndërsa në deklaratat e interesave private periodike vjetore 2014 – 2016 deklaroi me gjeneralitetet S.S. Nisur nga ky fakt, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime nëse bashkëshorti ka ndryshuar mbiemrin, si dhe qëllimin e këtij ndryshimi duke bashkëlidhur dokument shkresor ligjor për vërtetimin e ndryshimit të mbiemrit në rrugë zyrtare.

105. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, shpjegon<sup>33</sup> se bashkëshorti nuk e ka ndryshuar mbiemrin dhe se mbiemri i pasqyruar në dokumentet e gjendjes civile ka qenë dhe është “S”. Mbiemri “S” është përdorur nga bashkëshorti dhe familja e tij, që nga fëmijëria dhe në vijimësi, duke qenë një fakt i njohur se zëvendësimi i mbaresës “aj” me “i” është një dukuri e zakonshme në Shqipëri. Subjekti vendos në dispozicion të Komisionit një sërë dokumentesh zyrtare si: dëftesë, diplomë, vërtetime; Vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. \*\*\*, datë 23.4.1998, “Për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese” etj., ku mbiemri i bashkëshortit është S. Gjithashtu edhe në disa libra që ka botuar bashkëshorti i subjektit, mbiemri i përdorur ka qenë S.

106. Bashkëshorti i subjektit në formularin e vetëdeklarimit të datës 25.4.2016, në rubrikën B, titulluar “gjeneralitete të mëparshme”, ka deklaruar faktin e përdorimit të mbiemrit “S”, por pa e ndryshuar atë në aktet e gjendjes civile.

107. Komisioni hetoi lidhur me pasuri të paluajtshme apo të drejta reale të z. S.S., me mbiemrin S., duke i kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, bankave, OSHEE-së, UKT-së dhe Regjistrin noterial.

- a) Nga përgjigjet e ASHK-së nuk rezulton se ka pasuri të tjera të regjistruara në emër të z. S. S., të ndryshme nga ato të regjistruara me mbiemrin S.
- b) OSHEE-ja<sup>34</sup> informon se me emrin S.S., identifikohen dy abonentë me kontratë të furnizimit në instancën e Kavajës. Këto dy kontrata janë verifikuar duke dërguar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2020, kundrejt FSHU-së dhe nga përgjigjja e ardhur nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2020, nuk kanë rezultuar të dhëna që të ngrenë dyshime për hetime të mëtejshme.
- c) UKT-ja informon se në emër të z. S.S., nuk rezulton asnjë e dhënë për kontratën e shërbime Ujësjellës-Kanalizime.
- ç) DPSHTRr-ja informon se në emër të z. S.S., është regjistruar automjeti me targa \*\*\*, për të cilin ka informuar dhe më parë gjatë hetimit se ishte regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit.
- d) Ministria e Drejtësisë informon<sup>35</sup> se z. S.S., pas verifikimit në RNSH, është i regjistruar me mbiemrin S., si dhe vendos në dispozicion aktet noteriale të kryera prej tij.

<sup>33</sup> Pyetësori datë 9 janar 2020.

<sup>34</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 30.12.2019.

<sup>35</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

dh) U krye verifikimi pranë zyrës noteriale të znj. A.H.,<sup>36</sup> lidhur me 33 vërtetime nënshkrimi që rezultojn në emër të z. S.S., të cilat ishin vërtetim nënshkrimi lidhur me diplomime studentësh.

108. Në përfundim, nga hetimi i Komisionit nuk kanë rezultuar pasuri të tjera nga ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

109. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit gjithashtu, të deklarojë nëse bashkëshorti i saj gëzonte pasuri apo të drejta reale me mbiemrin “S”.

110. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“... me përgjegjësi të plotë ju informoj se në të gjitha deklaratimet e pasurisë, të kryera ndër vite, si dhe në deklaratën ‘Vetting’ e më pas, gjatë të gjithë këtij procesi, ne kemi pasur në vëmendje përdorimin e mbiemrit S., dhe kemi deklaruar gjithçka që bashkëshorti ka përfituar apo ka qenë i detyruar kundrejt të tjerëve, pavarësisht nëse është përdorur mbiemri ‘S.’ apo ‘S’. Në këto kushte, deklaroj se bashkëshorti im nuk ka asnjë pasuri apo të drejtë tjetër reale, që nuk është deklaruar apo nuk është verifikuar prej jush.”*

111. Në përfundim, trupi gjykues e vlerësoi të plotë hetimin lidhur me këtë çështje dhe nuk kishte dyshime të tjera lidhur me të.

112. DPSHTRr-ja, informon se në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit rezulton i regjistruar automjeti tip “Mercedes Benz”, si dhe vendos në dispozicion dosjen e tij.

Automjeti i vitit të prodhimit 2013 është blerë në vitin 2017, në vlerën 22.150 (njëzet e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, sipas faturës së datës 20.7.2017, pagesë e pranuar në bankë/çek. Subjekti deklaroi në pyetësor se pagesa shoqërisë shitëse “\*\*\*\*”, Bremen, Gjermani i është bërë nëpërmjet llogarisë së bashkëshortit në “Credins Bank”. Shpenzimet doganore për këtë automjet janë në vlerën 595.328 (pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e tetë) lekë, të cilat subjekti shpjegon se janë paguar nëpërmjet llogarisë në “Credins Bank”.

113. Nga dokumentacioni bankar i administruar ka rezultuar se pagesa e këtij automjeti është kryer nëpërmjet transfertës bankare nga llogaria nr. \*\*\* e z. S.S., në “Credins Bank” në datën 20.7.2017, të vlerës 22.150 (njëzet e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, kundrejt përfituesit “\*\*\*\*”. Vihet re se kjo llogari bankare është përdorur nga z. S.S., për arkëtimin e pagesave të ndryshme nga mësimdhënia, si dhe për përfitimin e qirasë së apartamentit të tij në Tiranë.

Në datën 28.7.2017 nga llogaria e tij nr. \*\*\*, në “Credins Bank” është paguar vlera prej 598.400 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekësh për zhdoganimin e automjetit. Vihet re se kjo llogari është përdorur nga z. S.S., për arkëtimin e pagës nga Shkolla e Magjistraturës dhe pagesave të ndryshme për mësimdhënie dhe konsulencë.

114. Nga analiza financiare rezultoi e justifikuar me burime të ligjshme blerja e këtij automjeti.

115. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, bashkëshorti i subjektit deklaroi shtëpi banimi në lagjen “Dëshmorët”, Vlorë, trashëgimi nga bashkëshortja, përfitim qiraje në vlerën 2.400 (dy mijë e katërqind) euro; në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 deklaroi vlerën 2.400 (dy mijë e katërqind) euro, nga qiraja e shtëpisë në Vlorë; në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 deklaroi të ardhura nga qiraja që ka në Vlorë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

116. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 bashkëshorti i subjektit, deklaroi vlerën 8.000 (tetë mijë) euro dhënë hua motrës, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 deklaroi kthimin e kësaj huaje. Subjekti deklaroi në pyetësorin standard se në datën 23.5.2014, bashkëshorti i ka dhënë hua motrës së tij dhe kumatit (T., dhe E. Rr.) që jetojnë në Toronto, Kanada, vlerën 8.000 (tetë mijë) euro, si ndihmë për të financuar blerjen e banesës së tyre, veprim

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2020.

i cili është kryer nëpërmjet sistemit bankar<sup>37</sup>. Kjo vlerë i është kthyer përsëri bashkëshortit në datën 5.4.2016, nga z. E.Rr., nëpërmjet veprimeve bankare<sup>38</sup>.

117. Përputhen deklaratimet e subjektit me veprimet e kryera dhe rezultatet e hetimit.

118. **Apartament banimi me sip. 55.1 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. “\*\*\*”, Vlorë** (apartament i cili është përfituar nga trashëgimlënësja P.Gj., nga privatizimi banesave). Referuar dëshmisë së trashëgimisë së gjyshes P.Gj., me nr. \*\*\* vendimi, datë 31.3.2011, në emër të shtetasve E., dhe K.S., ka kaluar dhe është regjistruar ky apartament.

119. ZVRPP-ja Vlorë<sup>39</sup> vendos në dispozicion Kontratën e Shitblerjes me rezervë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.2.2016, ku znj. E.S., dhe z. K.S., kanë rënë dakord që z. F.H., të blejë apartamentin me sip. 55.1 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. “\*\*\*”, Vlorë, kundrejt vlerës 20.000 (njëzet mijë) euro, nga të cilat 10.000 (dhjetë mijë) euro janë likuiduar më 27.12.2016, nëpërmjet llogarisë së noterit<sup>40</sup>, ndërsa diferenca e mbetur prej 10.000 (dhjetë mijë) euro do të likuidohej deri më 15.3.2017.

Blerësi ka të drejtën e regjistrimit të kësaj prone, por do të jetë e barrësuar në favor të shitësit deri në likuidimin e plotë të vlerës së mbetur<sup>41</sup>.

Sipas deklaratës periodike vjetore të vitit 2017 të subjektit të rivlerësimit, pjesa tjetër e pagesës prej 10.000 (dhjetë mijë) euro është likuiduar në datën 23.3.2017.

120. Subjekti i rivlerësimit për këtë apartament deklaron se vlera prej 20.000 (njëzet mijë) euro është depozituar në gusht të vitit 2017, në “Credins Bank”, duke kaluar e ndarë në pjesë të barabarta me nga 10.000 (dhjetë mijë) euro, në llogarinë e fëmijëve E., dhe K.S.

Subjekti bashkëlidh Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2017, ku shtetasi K.S., deklaron se vlera prej 10.000 (dhjetë mijë) euro është likuiduar nga z. F.H., nëpërmjet llogarisë bankare të noterit në “Credins Bank” më 15.3.2017 dhe më pas kjo vlerë ka kaluar në llogari të shtetasës E.S.

121. Fëmijët e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit e kanë fituar këtë pasuri si trashëgimtarë të gjyshes së tyre, znj. P.Gj.

Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. \*\*\*, datë 31.3.2011, gjykata ka caktuar rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të znj. P.Gj., e cila ka ndërruar jetë në datën 19.2.2011, ku si trashëgimtarë ligjorë të saj janë përcaktuar shtetasi E.S., dhe K.S., në ½ secili.

122. Gjatë hetimit rezultoi se znj. P.Gj., e kishte fituar pronësinë mbi këtë apartament me kontratën për privatizimin e banesës së datës 27.8.1993, kundrejt vlerës 1.822 (një mijë e tetëqind e njëzet e dy) lekë.

123. Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri.

124. **Depozitë bankare në “Credins Bank”,** në emër të shtetasve E., dhe K.S., me gjendje në datën 30.12.2016, në vlerën 23.786 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) euro. Burim krijimi: trashëgimi nga gjyshja, znj. P.Gj., sipas dëshmisë së trashëgimisë, nr. \*\*\* vendimi, datë 31.3.2011. Zotërimi: 50 %. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të gjyshes është trajtuar më poshtë në rubrikën persona të tjerë të lidhur.

<sup>37</sup> Subjekti i bashkëlidh pyetësorit standard tranfertën e kësaj shume nëpërmjet llogarisë në “Credins Bank”, si dhe kthimin e kësaj vlere nëpërmjet MoneyGram. Konfirmohet dhënia e huas edhe nga dokumentacioni bankar i administruar nga Komisioni (transferuar vlera 8.000 euro, në datën 23.5.2014 nga llogaria nr. \*\*\* “Credins Bank” e z. S.S., të shtetasit T., dhe E.Rr., me përshkrimin “hua personale”).

<sup>38</sup> Subjekti i bashkëlidh pyetësorit deklaraten e datës 11 prill 2016 të znj. T. S. Rr., dhe bashkëshortit të saj, ku deklarojnë se në datën 5 prill 2016 kanë depozituar në llogarinë bankare të z. S.S., vlerën 8.000 euro. “AK-INVEST” me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019, konfirmon se z. S.S., ka tërhequr nga ky institucion në datën 25.4.2016, vlerën totale prej 8.000 euro, dërguar nga z. E. Rr.

<sup>39</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>40</sup> Subjekti bashkëlidh eksraktin e “Credins Bank” sipas të cilit z. H., paguan apartamentin në llogarinë e noterit, e cila në datën 29.12.2016 i kalon në llogarinë e znj. E.S.

<sup>41</sup> Kartelat e pasurisë nuk i kanë të gjitha seksionet për të bërë të mundur kontrollin e barrës.

125. **Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”**, në emër të shtetasve E., dhe K.S., me gjendje në datën 30.12.2016, në vlerën 10.008 (dhjetë mijë e tetë) euro. Burimi i krijimit: sipas kontratës së shitblerjes me rezervë nr. \*\*\*, datë 29.12.2016.

126. **Llogari në “Alpha Bank”**, në emër të shtetasës E.S., me gjendje në datën 29.12.2016, në vlerën 122.322 (njëqind e njëzet e dy mijë e treqind e njëzet e dy) lekë dhe llogari në vlerën 5.523 (pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre) euro. Burim krijimi: sipas dëshmisë së trashëgimisë së gjyshes P. Gj., vendimi nr. \*\*\*, datë 31.3.2011. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të gjyshes është trajtuar më poshtë në rubrikën persona të tjerë të lidhur.

127. **Llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”**, në emër të znj. E.S., me gjendje në vlerën 3.575 (tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) USD. Kjo llogari është hapur në gusht të vitit 2002, si llogari “futura” [në momentin e hapjes ka qenë në vlerën 1.000 (një mijë) USD].

128. **Llogari rrjedhëse e pagës në “Societe General”** (Strasbourg Francë), në emër të shtetasës E.S., gjendja e llogarisë në datën 29.12.2016, ka qenë 576 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro.

129. Lidhur me vlerat në depozitat dhe në llogaritë bankare si më lartë nuk janë konstatuar problematika. Këto vlera janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit.

130. **Depozitë bankare në “Credins Bank”** në emër të shtetasve E., dhe K.S., me gjendje në datën 30.12.2016, në vlerën 23.786 (njëzet e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) euro. Burimi i krijimit: trashëgimi nga gjyshja, P.Gj., sipas dëshmisë së trashëgimisë vendimi nr. \*\*\*, datë 31.3.2011. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të gjyshes është trajtuar më poshtë në rubrikën persona të tjerë të lidhur.

131. **Llogari në “Alpha Bank”** me gjendje në datën 29.12.2016, në vlerën 337.070 (treqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë) lekë dhe llogari në vlerën 5.502 (pesë mijë e pesëqind e dy) euro, në emër të z. K.S. Burimi i krijimit: sipas dëshmisë së trashëgimisë të gjyshes, P. Gj., vendimi nr. \*\*\*, datë 31.3.2011. Zotërimi: 100 %. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të gjyshes është trajtuar më poshtë në rubrikën persona të tjerë të lidhur.

132. **Llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”** me gjendje në vlerën 3.777 (tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) USD, në emër të z. K. S. Kjo llogari është hapur në gusht të vitit 2002, si llogari “futura” [në momentin e hapjes ka qenë në vlerën 1.000 (një mijë) USD].

133. Lidhur me vlerat në depozitat dhe llogaritë bankare si më lartë, nuk janë konstatuar problematika. Këto vlera janë reflektuar në analizën financiare.

### **Persona të tjerë të lidhur**

134. Nëna e bashkëshortes së parë, të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. P. Gj. Fëmijët e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shtetasit E., dhe K.S., kanë trashëguar nga gjyshja e tyre znj. P.Gj., si më poshtë:

|   |                    |
|---|--------------------|
| E ardhur për E.S., sipas vendimit të gjykatës “Alpha Bank”, datë 30.12.2014 | 5.517 euro         |
| E ardhur për K.S., sipas vendimit të gjykatës “Alpha Bank”, datë 30.12.2014 | 5.523 euro         |
| E ardhur për E.S., sipas vendimit të gjykatës “Alpha Bank”, datë 9.4.2012   | 336.493 lekë       |
| E ardhur për K.S., sipas vendimit të gjykatës “Alpha Bank”, datë 12.1.2015  | 336.493 lekë       |
| E ardhur nga P.Gj., derdhje në llog. 3 emërore 20,000 euro                  | 20.000 euro        |
| <b>TOTAL likuiditete trashëguar nga gjyshja</b>                             | <b>35.840 euro</b> |
| Trashëguar apartament nga gjyshja   | 20.000 euro        |

135. Komisioni hetoi mbi mundësitë financiare të znj. P.Gj., për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë e sipërcituara, duke i kërkuar subjektit të provonte me dokumentacion ligjor burimet.

136. Subjekti shpjegon se burimet janë, si më poshtë:

- a) Të ardhurat nga puna e disa viteve në Greqi, ku znj. P.Gj., e cila ishte me origjinë minoritare (kombësi greke) kishte shkuar në fillim të viteve '90. Për këto të ardhura, subjekti deklaroi se së bashku me bashkëshortin nuk kanë gjetur të dhëna lidhur me punëdhënësin/punëdhënësit.
- b) Të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Vlorë, të përfituar nga privatizimi, të cilin e kishte dhënë me qira, duke qenë se znj. Gj., në vitet e para pas vitit 1990, banonte në mënyrë permanente në Greqi. Subjekti deklaroi se ka qenë e pamundur të gjenden të dhëna për qiradhënësin/qiramarrësit, apo ndonjë kontratë e shkruar.
- c) Të ardhura nga pensioni mujor në Greqi, të znj. P.Gj., nga viti 2003. Sipas të dhënave të lëshuara nga O.G.A. (Organizata e Përfitimeve Sociale), Dega e Regjistrimit të Pensioneve Janinë, znj. P. Gj., ka marrë nga korriku i vitit 2003 deri në shkurt të vitit 2011 (kur ndërroi jetë), një vlerë totale prej 32.080 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë) euro. Subjekti bashkëlidh kopje të vërtetimit të pensioneve të lëshuara nga O.G.A. (Organizata e Përfitimeve Sociale, lëshuar nga Ministria e Punës, Mbrojtjes Sociale dhe Solidaritetit Social Greqi). Dokumentet janë fotokopje të dokumenteve të përkthyer, të noterizuara më 10.8.2018. Sipas këtij dokumentacioni, znj. P. Gj., ka përfituar pension nga shteti grek gjatë periudhës 2004 – 2011, vlerën totale prej 31.520 (tridhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet) euro.
- ç) Të ardhura nga pensioni i pleqërisë së znj. P.Gj., në Shqipëri, paguar për periudhën 1.9.1992 – 30.10.2010, në vlerën totale prej 1.409.974 (një milion e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekësh. Subjekti bashkëlidh vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë.
- d) Subjekti bashkëlidh edhe dokumentin bankar të marrë nga “Banka Kombëtare e Greqisë”<sup>42</sup> në Janinë, sipas të cilit znj. P.Gj., ka depozituar herë pas here të ardhurat e saj, si dhe duke investuar në blerjen e letrave me vlerë. Subjekti shprehet se rezultojnë që në total znj. Gj., të ketë depozituar vlerën 15.543.94 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre presje nëntëdhjetë e katër) euro, ndërkohë që në vitet 2009 dhe 2010 ka tërhequr një vlerë totale prej 21.400 (njëzet e një mijë e katërqind) euro (21.000 euro në mars të vitit 2009 dhe 400 euro në mars të vitit 2010).

136.1 Në vijim, subjekti shpjegon se nga analiza e depozitimeve të kryera nga znj. P. Gj., dhe tërheqjeve, vlera e marrë prej saj rezultoi si nga depozitimi, ashtu edhe nga fitimi i interesave nga produktet e shitura nga banka dhe investimi i parave në to. Kjo do të thotë se pjesën tjetër të pensionit, që i paguhej nga shteti grek dhe që tërhiqej në *cash*, nuk i ka depozituar në llogarinë e mësipërme, duke qenë kjo vlerë 16.537 (gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) euro diferenca mes 32.080 (tridhjetë e dy mijë e tetëdhjetë) dhe 15.543 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) euro. Të ardhurat e mësipërme (të tërhequra nga banka dhe pjesa e mbetur e pensionit) duhet të jenë depozituar nga e ndjera në llogaritë e saj në Shqipëri (bashkëlidhur informacioni i marrë me kërkesë të djalit, K.S., në “Credins Bank” dhe “Alpha Bank”).

137. Në përfundim, trupi gjykues nuk gjeti shkaqe për të vazhduar më tej hetimin apo dyshime që lidhen me subjektin e rivlerësimit. Për pasuritë trashëgimore të fëmijëve të z. S., të trashëguar nga nëna, gjyshi dhe gjyshja e tyre, përveç se u vlerësuan plotësisht të justifikuar dhe të ligjshme, Komisioni nuk konstatoi asnjë lidhje mes tyre dhe subjektit të rivlerësimit znj. Edlira Petri.

### **Analiza financiare për vitet 2003 – 2016**

138. Në analizën financiare të periudhës 2003 – 2009 është përfshirë subjekti i rivlerësimit, që rezultoi të ketë qenë beqare. Në analizën financiare të periudhës 2010 – 2016, duke qenë se subjekti është martuar me z. S.S., në vitin 2010<sup>43</sup>, janë përfshirë edhe bashkëshorti, vajza e tyre

<sup>42</sup> Dokumentet janë fotokopje të dokumenteve të përkthyer, të noterizuara pa vulë apostile.

<sup>43</sup> Sipas deklaratimit të subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, si dhe në pyetësorë.



S.S., si dhe dy fëmijët e bashkëshortit nga martesë e parë, E., dhe K.S., të cilët janë në certifikatën familjare të subjektit.

Theksohet se në analizën financiare të vitit 2010, për efekt të pasqyrit korrekt të pasurive të z. S.S., janë përfshirë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të krijuara prej tij përpara martesës me subjektin, te seksioni i pasurive dhe njëkohësisht te të ardhurat (impakti i këtij veprimi në analizën e vitit 2010 rezulton 0).

139. Më konkretisht, analiza financiare bazohet mbi elementet e mëposhtme:

1. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat respektive të këtyre pasurive, analiza financiare përfshin edhe pasuritë e paluajtshme dhe likuiditetet e fëmijëve të bashkëshortit të subjektit, E., dhe K. S., të përfituara nëpërmjet trashëgimisë nga nëna dhe gjyshja e tyre e ndjerë (trajtuar më sipër).

2. Gjendja e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga informacioni i administruar nga bankat, si dhe gjendjen *cash* të likuiditetit të deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore. Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka saktësuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti<sup>44</sup>, duke konfirmuar deklaratimet e bëra në deklaratat periodike vjetore. Subjekti ka shpjeguar se në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve të disponuara në fund të çdo viti përkatës. Këtu bën përjashtim deklarimi i kryer në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, në të cilën subjekti ka deklaruar gjendjen e kursimeve *cash* me burim të ardhurat nga paga të këtij viti, si dhe të viteve paraardhës (për shkak të paqartësisë mbi mënyrën e deklarimit të likuiditeteve, në vitin 2003).

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 ka deklaruar kursime në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë, të cilat përfshijnë gjendjen e llogarisë së pagës dhe gjendjen e likuiditeteve *cash*, të disponuara në fund të këtij viti.

Subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime në lidhje me likuiditetet *cash* edhe në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 17.7.2009<sup>45</sup>.

Subjekti, i pyetur nga Komisioni, ka sqaruar edhe gjendjen *cash* të bashkëshortit në fund të çdo viti për gjithë periudhën e deklarimit 2003 – 2016, ndërsa nuk dilte qartë nëse kanë qenë shtesa apo gjendje në fund të vitit. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2014, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar “Gjendja *cash* deklaruar më parë lekë 3.450.000. Gjendja *cash*-Euro 5.000”, ndërsa në Deklaratën “Vetting” ai ka deklaruar “Gjendja *cash*-0”. Në lidhje me këtë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në deklaratën periodike të viteve 2011 dhe 2013, kur ka deklaruar gjendjen *cash*, bashkëshorti ka pasur në vëmendje sasinë e parave që disponohej në dorë prej tij në datën 31 dhjetor të vitit, për të cilin deklarohet. Sa i përkiste deklaratës para fillimit të detyrës datë 18.11.2014, e ndryshme nga deklarimi periodik vjetor, ku pasqyroheshin shtesat dhe pakësimet për çdo vit, subjekti sqaron se deklarimi i gjendjes *cash* në lekë nuk përfaqëson shumën që disponohej në atë datë. Meqenëse në këtë deklaratë, për vetë specifikën e saj, janë listuar të gjitha pasuritë e grumbulluara në vite, përfshirë edhe pasuri që nuk ekzistonin në momentin e deklarimit (sikurse është rasti i automjetit tip “Renault” në pronësi të znj. Edlira Petri), të njëjtën cilësi ka pasur edhe gjendja *cash* prej 3,450,000 lekësh; pra, që nuk ekzistonte në atë moment. Subjekti sqaron se sikurse mund të konstatohej lehtësisht edhe nga DPV-të, në vite, shuma e deklaruar rezulton një mbledhje mekanike e të gjitha deklaratimeve të mëparshme *cash* të të dy bashkëshortëve. Sipas subjektit, kjo mënyrë pasqyrimi është menduar në atë kohë nga bashkëshorti si e përshtatshme, duke qenë se përbri është bërë sqarimi “deklaruar më parë”, në dallim nga pasuria me nr. 13, f. 4 (gjendja *cash* prej 5.000 Euro), në të cilën nuk është bërë ky shënim. Po ashtu, referuar edhe listimit të pasurive sipas numrave rendorë nga 1 deri 10 (f. 3-4 e deklaratës), në të janë pasqyruar pasuritë e deklaruara në vitet e mëparshme. Më pas, duke filluar

<sup>44</sup> Pyetësoni i datës 30.8.2019, përgjigjja nr. 1.

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2019, nga ILDKPKI-ja.

nga numri 11 e në vijim, janë listuar pasuritë që ekzistojnë në momentin e deklaramentit, sikurse janë edhe likuiditetet, mes të cilave është renditur edhe gjendja *cash* prej 5.000 Euro. Në përfundim, në përgjigje të pyetjes së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “... në momentin e hartimit të deklaratës para fillimit të detyrës, gjendja e parave që disponohej *cash* nga bashkëshorti ishte 5.000 Euro”. Gjithashtu, subjekti ka ritheksuar se referuar Deklaratës “Vetting”, në të cilën nuk ka një deklarament të bashkëshortit për gjendje të parave *cash*, kjo do të thotë se nuk ka pasur në dorë asnjë shumë të hollash në momentin e deklaramentit.

Analiza financiare përfshin gjendjen e likuiditeteve *cash*, të deklaruara nga subjekti në deklaramentat periodike vjetore, si dhe mbështetur në deklaramentet e kryera në ILDKPKI dhe shpjegimet e dhëna në pyetësorin përkatës.

3. Të ardhurat e dokumentuara të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, bashkëshortit dhe fëmijëve të tij nga martesa e parë, ku përfshihen:

a. Të ardhura nga puna e subjektit të rivlerësimit si gjyqtare në periudhën 2003 – 2016, për të cilat ka paraqitur dokumentacionin justifikues përkatës.

b. Të ardhurat e bashkëshortit, z. S.S. Nga hetimi ka rezultuar se ka pasur të ardhura nga burime të shumta (rreth 30 të tilla) në periudhën 1991 – 2016, duke përfshirë të ardhurat nga paga në institucione të ndryshme publike, nga avokatia, mësimdhënia dhe bashkëpunimi si ekspert ligjor me shumë organizata ndërkombëtare. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat bazuar në dokumentacionin justifikues të paraqitur nga subjekti.

Subjekti ka deklaruar gjithashtu se bashkëshorti ka përfituar të ardhura edhe nga botimi i disa titujve shkencorë në vitet 2003 – 2014, të cilët janë përdorur si tekste mësimore të shkencës juridike në disa institucione të arsimit të lartë dhe në Shkollën e Magjistraturës. Znj.Petri ka paraqitur kopje të kopertinave të këtyre botimeve, si dhe statistika mbi numrin e studentëve për periudhën në fjalë dhe ka deklaruar se këto libra nga viti 2012, janë botuar nga shtëpia botuese “\*\*\*\*” dhe para këtij viti janë botuar nga shtëpia botuese “\*\*\*\*” me administratore znj. Z.H. Subjekti ka paraqitur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.9.2019, nga znj. Z.H., e cila deklaron në cilësinë e administratores së shtypshkronjës “\*\*\*\*” se ka pasur marrëdhënie kontraktore me z. S.S., si autor librash (me tirazh shumë të lartë 1000 - 1500 kopje), për periudhën 1999 – 2011, por për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk disponon dokumentacion justifikues. Administratorja konfirmon ekzistencën e marrëdhënieve midis tyre dhe faktin se çdo veprim i kryer ka qenë konform legjislacionit civil dhe fiskal në fuqi. Subjekti ka paraqitur edhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2019 nga DRT-ja Tiranë, sipas të cilit shtëpia botuese “\*\*\*\*” ka kryer pagesa të tatimit në burim për periudhën 2008 – 2011, por pagesat janë kryer në total dhe nuk identifikohen individët, të cilëve i takon pagesa e tatimit. *Këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.*

c. Subjekti ka deklaruar në deklarament “Vetting” se vajza e bashkëshortit, E.S., është punësuar në vitin 2016 si juriste në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë, në Këshillin e Evropës, si përfaqësuese në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Subjekti ka paraqitur vërtetim mbi punësimin dhe pagën e përfituar nga Avokatura e Shtetit<sup>46</sup> dhe një kopje të ekstraktit të llogarisë bankare<sup>47</sup> të znj. E.S., te banka “Societe Generale” në Francë, në të cilën ka përfituar pagën nga ky institucion. Në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet (në Francë) për vitin 2016, për periudhën në të cilën ka qenë në Strasburg për llogari të shtetit shqiptar.

1. Shpenzimet, ku përfshihen:

a. Shpenzimet e jetesës

<sup>46</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 28.12.2016, nga Avokatura e Shtetit (dokument nr. 4/19, dosja ILDKPKI).

<sup>47</sup> Dokument nr. 4/18, dosja ILDKPKI.

Komisioni ka përllogaritur shpenzimet jetike vjetore sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja<sup>48</sup> gjatë kontrollit të deklaratës së pasurisë së subjektit Edlira Petri. Ky institucion konfirmoi se shpenzimet jetike i referohen treguesve statistikorë të përllogaritur nga INSTAT-i dhe ka vënë në dispozicion vlerat e konsumit vjetor/frymë për periudhën 2003 – 2016. Nga shqyrtimi i këtyre të dhënave rezulton se për vitin 2007 është përdorur një vlerë shumë e lartë krahasuar me vitet e tjera (235.968 lekë konsum vjetor/frymë), ndërkohë që në vitet pasardhëse 2008 – 2011, konsumi/ frymë ka vlerën 136.620 (njëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë. Për këtë arsye, në analizën financiare të subjektit, për vitin 2007 është përdorur vlera e shpenzimeve jetike të vitit 2008.

b. Shpenzime të ndryshme të kryera nga karta e kreditit të bashkëshortit të subjektit në “Credins Bank” (nr. llogarie \*\*\*), sipas tabelës vijuese:

| VITI   | 2010         | 2011         | 2012         | 2013         | 2014         | 2015         | 2016         |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Shpenzime AMEX në euro   | 475 1        | 308 1        | 623          | 1 021        | 191          | 950          | 310          |
| Kursi i këmbimit Banka e Shqipërisë  | 138,81       | 138,3        | 139,72       | 140,21       | 140,11       | 137,65       | 135,27       |
| Shpenzime AMEX në lekë   | 65, 944      | 42 659       | 87 114       | 143 089      | 26 760       | 130 734      | 41 934       |
| Zbritje shpenzime të përfshira në anketën e buxhetit INSTAT (5 % e shpenzimeve jetike vjetore) | - 3 297 lekë | - 2 133 lekë | - 4 356 lekë | - 7 154 lekë | - 1 338 lekë | - 6 537 lekë | - 2 097 lekë |
| Shpenzime ekstra me kartë krediti  | 62 647 lekë  | 40 526 lekë  | 82 758 lekë  | 135 934 lekë | 25 422 lekë  | 124 198 lekë | 39 837 lekë  |

Theksohet se sipas anketës së buxhetit të familjes të përllogaritur nga INSTAT-i, zëri “veshje e të ngjashme” përbën rreth 5 % të vlerës totale të shpenzimeve jetike. Për këtë arsye, zërit “shpenzime me kartë krediti”, i është zbritur 5 % e vlerës totale të shpenzimeve jetike në vitet përkatëse, me qëllim përllogaritjen e saktë të këtyre shpenzimeve në analizën financiare.

c. Shpenzimet e udhëtimit sipas sistemit *TIMS*

Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të periudhës 2004 – 2009 shpenzime udhëtimit dhe qëndrimi jashtë vendit për subjektin dhe shpenzime udhëtimit për bashkëshortin dhe fëmijët e tyre për periudhën 2010 – 2016, bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, si dhe deklaratimet e subjektit në pyetësorët e drejtuar nga Komisioni<sup>49</sup>, sipas standardit të përdorur prej tij. Nuk janë përllogaritur shpenzime për udhëtimet e punës, për të cilat subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues.

Përllogaritja e këtyre shpenzimeve është kryer sipas metodologjisë së përcaktuar<sup>50</sup> nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Subjekti ka deklaruar se së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët e tij kanë kryer një sërë udhëtimeve jashtë vendit, gjatë të cilave kanë qëndruar te të afërmit dhe ka paraqitur<sup>51</sup> kopje të deklaratave të personave pritës, shoqëruar me kopje të dokumenteve të identifikimit të tyre, lëshuar nga autoritetet e huaja dhe të kontratave të qirave/pronësisë së banesave të tyre (në gjuhë të huaj). Për këto udhëtime janë përllogaritur shpenzime qëndrimi të reduktuara.

Nisur nga fakti se gjatë hetimit administrativ të kryer rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka përdorur dy mbiemra, Komisioni nxori nga sistemi *TIMS* të dhënat mbi udhëtimet e kryera prej tij me të dy mbiemrat, të cilat u përfshinë në analizën financiare.

ç. Shpenzime arsimimi për fëmijët e subjektit dhe bashkëshortit të saj

<sup>48</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019, nga ILDKPKI-ja.

<sup>49</sup> Pyetësori standard dhe pyetësori nr. 2, datë 30.8.2019, përgjigjja nr. 7.

<sup>50</sup> Vendimi nr. 11, datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit për subjektin e rivlerësimit, E. I.

<sup>51</sup> Përgjigjet e pyetësorit datë 13.1.2020.

- shpenzime shkollimi për vajzën, S. S., në shkollën jopublike “\*\*\*”, në periudhën 2013 – 2016, në vlerën totale 1.905.394 (një milion e nëntëqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti<sup>52</sup>;
- shpenzime shkollimi për djalë bashkëshortit, K.S., në universitetin jopublik “\*\*\*”, në periudhën 2014 – 2016, në vlerën totale 1.107.315 (një milion e njëqind e shtatë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë) lekë, sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti<sup>53</sup>;
- shpenzime shkollimi dhe jetese për vajzën e bashkëshortit, E.S., në G., Austri. Subjekti ka deklaruar se znj. E.S., ka studiuar në programin *master* “South East European Law and European Integration (LLM)” në periudhën 2012 – 2014. Analiza financiare e këtyre viteve përfshin shpenzimet e studimit<sup>54</sup> dhe jetesës<sup>55</sup>, në vlerën totale 3.754.749 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) lekë, duke u mbështetur në dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe deklaratimet e kryera nga subjekti.

#### d. Shpenzime mjekësore për znj. E.S.

Subjekti ka deklaruar se vajza e bashkëshortit, për shkak të një problemi shëndetësor, ka kryer disa udhëtime në SHBA ndër vite, me qëllim kryerjen e konsulencës shëndetësore, me ndihmën e z. P.A., (kushëri i parë i bashkëshortit), i cili është mjek në SHBA. Në prill të vitit 2010, znj. E. S., ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në spitalin “\*\*\*” në Filadelfia, ku u vendos që kjo ndërhyrje të kryhej falas. Subjekti ka paraqitur korrespondencën me *e-mail* me personelin e spitalit dhe kopje të një vërtetimi në gjuhën angleze nga mjeku i saj, në të cilin deklarohet se pacientja E.S., ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale në datën 29.4.2010 pranë kësaj strukture, e shoqëruar nga babai, S. S., dhe se kjo ndërhyrje dhe qëndrimi në spital i pacientes janë realizuar pa pagesë. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk janë përlogaritur shpenzime mjekësore në analizën financiare.

<sup>52</sup> Kopje të vërtetimit nr. \*\*\*, datë 21.11.2018 dhe vërtetimit nr. \*\*\*, datë 24.3.2017, nga “\*\*\*” sh.a.

<sup>53</sup> Kopje e vërtetimit nga “University \*\*\* Tirana” datë 9.11.2018.

<sup>54</sup> Kopje në gjuhën angleze të vërtetimit të tarifës së studimit, sipas këtij vërtetimi, vlera totale e tarifës shkollore për të gjithë kohëzgjatjen e *masterit* është 7.300 euro. Nga dokumentacioni i administruar, konfirmohet pagesa e vlerës 1.000 euro, në datën 8.2.2012 nga llogaria e z. S.S., dhe e vlerës 6.300 euro në datën 27.8.2012, nga llogaria e znj. E.S., në “Credins Bank”. Në analizën financiare të vitit 2014 është përfshirë edhe vlera 2.000 euro deklaruar nga subjekti në pyetësorin standard, përgjigjja nr. 6/6.

<sup>55</sup> Kopje në gjuhën gjermane të kontratës së qirasë për periudhën 3.9.2012 – 14.7.2013 (340 euro/muaj) dhe të kontratës së qirasë për periudhën 16.9.2013 – 14.7.2014 (360 euro/muaj). Subjekti deklaroi gjithashtu në pyetësorin standard, përgjigjja nr. 6/2 se znj. E.S., ka shpenzuar rreth 400 euro/muaj për ushqim.

## Analiza financiare 2003 – 2016

| Përshkrimi   | 2003             | 2004           | 2005           | 2006             | 2007             | 2008             | 2009             | 2010              | 2011              | 2012              | 2013              | 2014              | 2015              | 2016              | TOTAL             |                    |
|--|------------------|----------------|----------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|
| <b>1 PASURI</b>  | <b>1 800 000</b> | <b>0</b>       | <b>786 836</b> | <b>718 314</b>   | <b>-107 519</b>  | <b>578 767</b>   | <b>217 783</b>   | <b>-456 390</b>   | <b>14 760 402</b> | <b>3 855 956</b>  | <b>137 671</b>    | <b>2 187 931</b>  | <b>2 896 141</b>  | <b>2 801 947</b>  | <b>-69 567</b>    | <b>28 308 274</b>  |
| SR Autoveture Renault Twingo ***   |                  |                |                | 330 000          |                  |                  |                  |                   |                   | -330 000          |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| SR Autoveture Benz ***   |                  |                |                |                  |                  | 600 000          |                  |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 600 000           |                    |
| SR+BSH Apartament 99,5 m2 Qerret Golem Regjistruar pasurisë e bsh ne golem nga aluizni ne vitin 2011. 58,750 Eur |                  |                |                |                  | 7 267 551        |                  |                  | 7 767 551         |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 7 767 551         |                    |
| BSH+EVI+K Apartament Sip 186 m2 Rr *** 4/6 sokol 1/6 evi 1/6 Kejdi   | 1 800 000        |                |                |                  |                  |                  |                  | 4 300 000         |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 4 300 000         |                    |
| BSH Shtese kati 81,69 m2 Rr ***  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| BSH+EVI+K Truall 285 m2 L 28 *** trashigimi ish bsh nga e cila perfitoi  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| BSH+EVI+K - Garazh 47 m2   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| BSH+EVI+K - Njesi shterpbimi 47 m2   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| BSH+EVI+K - 5 apartamente banimi 66, 90, 89, 63 dhe 111 m2   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| EVI+KEIDI Apartament trashëguar nga gjyshja Rr ***** 55,1 m2 shitur 29/12/16                                     |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 | 2 705 400         |                   |                   |                   |                   | -2 705 400        | 0                 |                    |
| Apartament 86,5 m2 kryemadheni kavaje rivleresuar ne 2011 55,000 euro  | 1 000 000        |                |                | 6 739 700        |                  |                  |                  | -5 739 700        |                   |                   |                   |                   |                   |                   | -5 739 700        |                    |
| SHTESA/PAKESIME LIKUIDITETE  | 0                | 786 836        | 388 314        | -107 519         | -21 233          | 217 783          | -456 390         | 8 432 551         | 1 150 556         | 467 671           | 2 187 931         | 2 896 141         | 2 801 947         | 2 635 833         | 21 380 423        |                    |
| <b>TOTAL LIKUIDITETE</b>   | <b>0</b>         | <b>0</b>       | <b>786 836</b> | <b>1 175 150</b> | <b>1 067 631</b> | <b>1 046 399</b> | <b>1 264 181</b> | <b>807 792</b>    | <b>9 240 343</b>  | <b>10 390 899</b> | <b>10 858 571</b> | <b>13 046 502</b> | <b>15 942 642</b> | <b>18 744 589</b> | <b>21 380 423</b> | <b>105 751 957</b> |
| <b>2 DETYRIME</b>  | <b>0</b>         | <b>0</b>       | <b>0</b>       | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>          | <b>0</b>          | <b>0</b>          | <b>0</b>          | <b>-1 120 880</b> | <b>0</b>          | <b>-270 540</b>   | <b>-1 391 420</b> |                    |
| Kredi Bankare NRG 20,000 USD Sapol Sapolshi (ekivalent lokal)  |                  | 2 095 553      | -82 208        | -68 746          | -79 656          | -75 817          | -1 438 138       |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                    |
| Detyrim l bleresit te apartamentit te gjyshes 10,000 euro  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                   |                   | -1 352 700        | -1 352 700        |                    |
| Kredi bankare NRG 20,000 USD   |                  | 19 280         | -869           | -840             | -850             | -911             | -15 811          |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| Dhënie huaje motres ne Kanada 8,000 Euro   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 0                 |                   |                   |                   | -1 120 880        |                   | 1 082 160         | -38 720           |                    |
| <b>3 PASURI NETO (1-2)</b>   | <b>0</b>         | <b>786 836</b> | <b>718 314</b> | <b>-107 519</b>  | <b>578 767</b>   | <b>217 783</b>   | <b>-456 390</b>  | <b>14 760 402</b> | <b>3 855 956</b>  | <b>137 671</b>    | <b>2 187 931</b>  | <b>4 017 021</b>  | <b>2 801 947</b>  | <b>200 973</b>    | <b>29 699 694</b> |                    |
| <b>4 TË ARDHURA</b>  | <b>619 070</b>   | <b>801 250</b> | <b>792 460</b> | <b>794 380</b>   | <b>1 155 426</b> | <b>1 267 036</b> | <b>1 255 276</b> | <b>18 645 359</b> | <b>6 576 493</b>  | <b>5 698 974</b>  | <b>6 616 003</b>  | <b>7 486 638</b>  | <b>6 317 758</b>  | <b>4 556 720</b>  | <b>62 582 844</b> |                    |
| Te ardhura te dokumentuara Edlira Petri  | 619 070          | 801 250        | 792 460        | 794 380          | 1 155 426        | 1 267 036        | 1 255 276        | 1 095 778         | 750 602           | 1 160 057         | 1 171 015         | 1 236 357         | 1 216 938         | 1 218 306         | 14 533 951        |                    |
| Te ardhura te dokumentuara S.S.  | 2 717 713        | 2 646 834      | 3 747 070      | 2 088 484        | 2 923 197        | 3 074 980        | 3 885 566        | 3 803 056         | 3 120 491         | 4 202 424         | 5 415 197         | 4 656 502         | 4 740 498         | 3 322 410         | 29 260 578        |                    |
| Te ardhura nga interesat bankare Edlira Petri  | 0                | 0              | 0              | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                 | 0                 | 0                 | 29 792            | 46 124            | 23 829            | 16 004            | 115 748           |                    |
| E ardhur E. S., sipas vendimit Gjykates Alpha Bank 30/12/14  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 773 828           |                   |                   | 773 828           |                    |
| E ardhur K.S., sipas vendimit Gjykates Alpha Bank 30/12/14   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 773 828           |                   |                   | 773 828           |                    |
| E ardhur E. S., sipas vendimit Gjykates Alpha Bank 09/04/12  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 336 493           |                   |                   | 336 493           |                    |
| E ardhur K.S., sipas vendimit Gjykates Alpha Bank 12/01/15   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                   | 336 493           |                   | 336 493           |                    |
| E ardhur nga P.Gj., derdhje ne llog 3 emerore 20,000 Euro  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 2 776 200         |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 2 776 200         |                    |
| Trashëguar apartament nga gjyshja  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   | 2 705 400         |                   |                   |                   |                   |                   | 2 705 400         |                    |
| Te ardhura nga S.S., likuiditete (ne vitin 2010)   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 4 642 474         |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 4 642 474         |                    |
| Te ardhura nga S.S., pasuri (ne vitin 2010)  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 6 327 851         |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 6 327 851         |                    |
| <b>5 SHPENZIME</b>   | <b>93 964</b>    | <b>93 964</b>  | <b>109 557</b> | <b>239 445</b>   | <b>299 849</b>   | <b>321 394</b>   | <b>599 166</b>   | <b>1 515 444</b>  | <b>3 579 858</b>  | <b>3 564 468</b>  | <b>3 009 978</b>  | <b>3 371 852</b>  | <b>3 400 113</b>  | <b>3 070 513</b>  | <b>23 269 565</b> |                    |
| Shpenzime personale Edlira Petri   |                  |                |                |                  |                  |                  | 300 000          |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 300 000           |                    |
| Humbje nga nxjerrja jashte perdorimi e automjetit Renault  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   | 330 000           |                   |                   |                   |                   | 330 000           |                    |
| Ndertim dhe mobilim apartamenti (shtesa M. K.) viti 2011   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   | 2 000 000         |                   |                   |                   |                   |                   | 2 000 000         |                    |
| Shpenzime mobilimi te tjera  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  | 210 000           |                   | 400 000           |                   |                   |                   | 500 000           | 1 110 000         |                    |
| Shpenzime shkollimi dhe jetese E. S., Graz Austri  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   | 1 433 527         | 1 402 100         | 919 122           |                   |                   | 3 754 749         |                    |
| Shpenzime shkollimi S. S.  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   | 252 378           | 420 330           | 412 950           | 819 736           | 1 905 394         |                    |
| Shpenzime shkollimi K. S.  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 83 502            | 570 392           | 453 421           | 1 107 315         |                    |
| Shpenzime pushimesh jashte vendit  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 490 385           | 481 775           |                   | 972 160           |                    |
| Shpenzime legalizimi shtese kati 81 m2   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   | 15 957            |                   |                   |                   |                   |                   | 15 957            |                    |
| Shpenzime legalizimi apartamenti Qerret  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   | 68 499            |                   |                   |                   |                   |                   | 68 499            |                    |
| Takse ndertimi Golem   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   | 84 800            |                   |                   | 84 800            |                    |
| Tatim per rivleresimin e apartamenti P. Gj.  |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   | 14 009            |                   |                   |                   | 14 009            |                    |
| Tatim per rivleresimin e pasurise "M. K." 186 m2   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   | 230 083           |                   |                   |                   |                   | 230 083           |                    |
| Shpenzime jetese sipas ILDKPKI   | 93 964           | 93 964         | 109 557        | 109 557          | 136 620          | 136 620          | 136 620          | 683 100           | 683 100           | 627 966           | 564 096           | 989 991           | 1 121 380         | 940 368           | 6 426 903         |                    |
| Shpenzime udhetimi TIMS (deri ne vitin 2009 vetem SR)  |                  | 0              | 0              | 129 888          | 163 229          | 184 774          | 162 546          |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 640 437           |                    |
| Shpenzime udhetimi TIMS (nga 2010 SR + bsh dhe femijet)  |                  | 317 006        | 390 379        | 447 237          | 273 374          | 481 024          | 325 093          | 559 697           | 541 693           | 690 217           | 641 461           | 358 301           | 689 418           | 317 151           | 3 797 937         |                    |
|  | 103 720          | 112 850        | 140 772        | 142 005          | 122 195          | 40 057           |                  |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   | 0                 |                    |
| Shpenzime AMEX (karte krediti Credins) S.S.  |                  |                |                |                  |                  |                  | 70 148           | 62 647            | 40 526            | 82 758            | 135 934           | 25 422            | 124 198           | 39 837            | 511 322           |                    |
| <b>6 KURSIME</b>   |                  |                |                |                  |                  |                  |                  |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                   |                    |
| <b>DIFERENCA (TË ARDHURA - PASURI-SHPENZIME 4-3-5-6)</b>   | <b>525 106</b>   | <b>-79 550</b> | <b>-35 411</b> | <b>662 454</b>   | <b>276 810</b>   | <b>727 859</b>   | <b>1 112 499</b> | <b>2 369 513</b>  | <b>-859 322</b>   | <b>1 996 834</b>  | <b>1 418 094</b>  | <b>97 765</b>     | <b>115 699</b>    | <b>1 285 234</b>  | <b>9 613 585</b>  |                    |

140. Nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit ka rezultuar një balancë negative financiare në vlerën prej 974.283 (nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekësh. Në vitin 2011, subjekti rezulton në një balancë negative financiare në vlerën 859.322 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e dy mijë) lekë.

141. Për këtë shkak, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të shpjeguar lidhur me rezultatin negativ të pasqyruar në mënyrë të detajuar më lart, në vendim.

142. Në shpjegimet për barrën e provës subjekti sqaron: *“Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit si autor librash më lejoni të parashtroj argumentet, mbi bazën e të cilave vlerësoj se të ardhurat e realizuara dhe të deklaruara rregullisht, çdo vit, nga bashkëshorti im dhe që vijnë nga botimi dhe shitja e librave të shkruar prej tij, janë të ligjshme. Përgjatë viteve të fundit, kryesisht nga viti 2012 e në vijim, një pjesë e mirë e dokumentacionit ligjor e fiskal për botimin e librave të bashkëshortit tim është i ruajtur, por edhe i aksesueshëm lehtësisht<sup>56</sup>. Situata nuk paraqitet e njëjtë për periudhën përpara vitit 2011. Për këtë arsye, nisur nga rëndësia që ka për mua dhe, në veçanti, për bashkëshortin tim botimi i librave dhe qëndrimi që duhet të mbahet për të ardhurat që realizohen prej tyre, do të parashtroj disa argumente që shpresojmë të kontribuojnë për një vendimmarrje të drejtë. Është i vërtetuar, ashtu si edhe ‘një fakt i njohur botërisht’ se botimet e bashkëshortit tim, S.S., si: ‘E drejta administrative 2’, ‘Kontrolli kushtetues’, ‘Drejtësia kushtetuese në zhvillim’, ‘Gjykata administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën’, ‘E drejta administrative procedurale’ janë libra të botuar, të njohur si literaturë e detyrueshme në programet mësimore, por edhe të shitur rregullisht, me një tirazh të arsyeshëm, nga viti 1999 e në vijim (shihni kopertinat dhe vërtetimet përkatëse). Është po ashtu e vërtetuar se numri i studentëve në fakultetet e drejtësisë, në veçanti, pas vitit 2007 dhe pas hapjes së fakulteteve jopublike, është rritur ndjeshëm. Sipas të dhënave zyrtare numri i studentëve të drejtësisë nga 10.165, në vitin 2007 arriti në 15.033 studentë në vitin 2011 (shihni shkresën e MASH). Botimi dhe ribotimi i këtyre librave, për shkak të një numri shumë të madh studentësh (ku çdo vit pranoheshin rreth 6.500 studentë), por edhe të qenies së tyre si literaturë e detyrueshme në fakultetet e drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe në Shkollën e Magjistraturës (bashkëlidhur dokumentacioni përkatës nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës), nga viti 1998 e në vijim, ka qenë i përvitshëm dhe në tirazh të arsyeshëm. Për rrjedhojë, mund të thuhet se nga botimi dhe shitja e këtyre librave janë përfituar edhe të ardhura.*

*Konkluzioni i parë që nxirret në këtë rast është se të ardhurat, që janë përfituar nga librat e botuar dhe të ribotuar në vite, e identifikojnë qartësisht burimin.*

*Ligjshmëria e burimit vërtetohet nga deklarimi i të ardhurave dhe nga pagesa e tatimeve, që janë dy detyrime që duhet të plotësojë subjekti. Ky është një standard kushtetues dhe që vlerësohet, në varësi të çdo rasti konkret. Deklarimi i të ardhurave ka rëndësinë e vet, që në çdo rast është përmbushur nga subjekti, por po aq rëndësi ka edhe vërtetimi i pagimit të tatimeve. Nuk mund të mos merret në konsideratë edhe fakti se mungesa e detyrimit (në kuadër të deklarimit të pasurive në ILDKPKI), për të paraqitur edhe dokumente justifikuese/provuese (me përjashtim të një viti), bëri që, fatkeqësisht bashkëshorti im të mos kërkonte nga mbajtësi në burim i tatimit dokumente dhe, për rrjedhojë, të mos i ketë edhe sot ato.*

*Së pari: nëse i referohemi të gjitha deklaratave periodike vjetore në vite (duke marrë vetëm periudhën para vitit 2011, kur gjetja e dokumentacionit paraqet vështirësi), kuptohet se përherë, autori S. S., ka deklaruar vetëm të ardhurat neto, që janë përfituar nga librat e botuar, të paguara nga subjekti tatimpagues ‘\*\*\*’, pas përmbushjes edhe të detyrimit ligjor për mbajtjen e tatimit në burim për të ardhurat. Mjafton të shihen deklaratat periodike vjetore në vite për të gjykuar mbi këto të ardhura. Konkretisht, është përfituar: për vitin 2008, vlera prej*

<sup>56</sup> Ky është edhe viti kur bashkëshorti im filloi të bëjë deklarinimin personal të të ardhurave në organet tatimore (DIVA), si subjekt me të ardhura mbi 2.000.000 lekë.

1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekësh; për vitin 2009, vlera prej 1.000.000 (një milion) lekësh; për vitin 2010, vlera prej 1.000.000 (një milion) lekësh; për vitin 2011, vlera prej 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekësh. Deklarimi për vitin 2011 i të ardhurave nga libri në vlerën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, e cila i korrespondon një tirazhi prej 1000 kopje të librit 'E drejta Administrative', ndërkohë që numri i studentëve të drejtësisë për këtë vit ka arritur në 15.033 studentë (numri më i lartë në të gjithë vitet), dhe ky është tregues për përfitimin e një vlere të arsyeshme dhe aspak abuzive.

Së dyti: mbajtja dhe pagesa e tatimit në burim ishte një detyrim ligjor, në radhë të parë, i subjektit tatimpagues që kryente pagesën. Subjekti tatimpagues '\*\*\*', që ka botuar librin 'E drejta administrative 2' dhe 'Kontrolli kushtetues', aktualisht është pasiv; dhe për rrjedhojë është e pamundur të gjendet dokumentacioni përkatës. Nga deklarata noteriale që ka dhënë pronari i vetëm i këtij subjekti, znj. Z.H., e cila ka deklaruar se nuk e dispononte dokumentacionin e kërkuar, për arsye të kohës shumë të gjatë nga përfundimi i marrëdhënieve kontraktore mes tyre, ka pranuar se të ardhurat e përfituara janë neto, duke qenë se tatimi për të është mbajtur në burim nga botuesit, në përmbushje të detyrimit të tyre ligjor.

Nga ana tjetër, vetë Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën bashkëlidhur informon se për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, lidhur me librin 'E Drejta Administrative 2', shtëpia botuese '\*\*\*' ka kryer pagesa tatimi në burim".

Mbi këto argumente, subjekti i rivlerësimit kërkoi të vlerësohej si një kërkesë e pranueshme, e arsyeshme dhe aspak abuzive që burimi i krijimit të të ardhurave nga shitja e librave për bashkëshortin e saj, të konsiderohet i ligjshëm.

143. "Për sa u përket viteve 2004 dhe 2005, kur rezultojnë diferenca negative, përkatësisht në vlerat 77.950 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë dhe 35.411 (tridhjetë e pesë mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekë, si fillim konstatoj se llogaritjet mbajnë në konsideratë deklarimin strikt të kryer në këto vite, nga ana ime. Duke pranuar si të sakta llogaritjet e kryera nga ana juaj dhe që bazohen në një interpretim objektiv të asaj që është deklaruar në vitet 2003, 2004 dhe 2005, do të kërkoja të merrnit në konsideratë qasjen subjektive që kam pasur në kohën e deklarimeve të mësipërme, sikurse shpjegimet e dhëna para ILDKPKI-së dhe ndryshimin e sjelljes sime pas kësaj kohe, duke riparuar të metat në deklarim. Përpos paqartësisë në deklarinimet e tri viteve të para, ju lutem konsideroni edhe peshën relative që zënë diferencat negative në raport me tërësinë e fakteve të shqyrtuara.

Për sa i përket balancës negative financiare në vlerën prej 859.322 (tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e njëzet e dy) lekësh në vitin 2011, vlerësoj se ajo vjen për shkak të një gabimi në llogaritjen e të ardhurave në atë vit. Mendoj se shkak për këtë duhet të jenë disa të dhëna jo të sakta që përmbajnë vetë dokumentet e organeve shtetërore apo jopublike, të depozituara pranë jush".

144. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti për vitin 2011, subjekti ka deklaruar burimet e tyre, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës sipas të cilave rezultojnë:

- Paga si gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për periudhën janar – gusht, plus dy paga shpërblim për shkak të përfundimit të mandatit, në shumën totale 1.588.637 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë.

Në DPV-në e vitit 2011 është deklaruar se të ardhurat e përfituara për periudhën janar-gusht 2011 kanë qenë në shumën 1.588.637 lekë (shihni deklarinimin në DPV-në e vitit 2011).

Nga këqyrja e dokumenteve të marra posaçërisht për procedurën e Rivlerësimit Kalimtar, rezultojnë se në vërtetimin e lëshuar nga Gjykata Kushtetuese në datën 14.10.2016 (dokumentacion i nxjerrë me kuadrin e plotësimit të Deklaratës "Veting") rezultojnë se të ardhurat për vitin 2011 janë përcaktuar në shumën 1.221.437 (një milion e dyqind e njëzet e

*një mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) lekë, duke mos përfshirë shumën prej 367.200 (treqind e gjashtëdhjetë shtatë mijë e dyqind) lekësh (të ardhura shpërblim 2 paga nga përfundimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues).*

*Shuma 1.588.637 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, është pasqyruar në deklaratën vjetore të vitit 2011, ajo vërtetohet edhe nga llogaria e bashkëshortit në “Raiffeissen Bank”<sup>57</sup>. Po ashtu, ky fakt gjen pasqyrim të saktë në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2019, i cili u kërkua nga bashkëshorti, në kuadër të procedurës së kandidimit të tij për vendin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.*

- *Të ardhura nga pagesa kalimtare (ISSH) në shumën 416,160 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë)lekë.*

*Me përfundimin e mandatit si gjyqtar kushtetues dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare në datën 2 gusht 2011, bashkëshorti, nga shtatori i vitit 2011 është paguar rregullisht nga ISSH-ja me pagesë kalimtare, në shumën 416,160 lekë, të deklaruara edhe në DPV-në për vitin 2011 (104,040 lekë në muaj). Pagesa mujore në këtë shumë rezulton si në veprimet e kryera në llogarinë bankare të bashkëshortit ashtu edhe në vërtetimin e datës 25.10.2016, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili është depozituar pranë jush.*

- *Të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës në shumën 326,880(treqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.*

*Për shkak të angazhimit në mësimdhënie dhe trajnimeve në këtë shkollë, bashkëshorti im, si edhe në vite të tjera, ka përfutuar të ardhura nga kjo veprimtari në shumën e mësipërme. Lidhur me të ardhurat për vitin 2011, subjekti sqaron se ka një pasaktësi në deklaratimet që i përkasin këtij viti. Me përfundimin e mandatit si gjyqtar kushtetues, bashkëshorti ka përpiluar në muajin gusht të vitit 2011 deklaratën pas përfundimit të detyrës dhe ka deklaruar si të ardhura nga SHM-ja shumën prej 144,000 (njëqind e dyzet e katr mij) lekësh. E njëjta shumë është shënuar edhe në DPV-në e atij viti të përpiluar nga unë si subjekt deklarues. Në fakt, të ardhurat në total sipas vërtetimit nga SHM-ja për këtë vit, janë si më sipër, treguar në vlerën 326,880 (treqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë, të kaluara edhe nëpërmjet sistemit bankar. Sqaroj se gabimi i kryer në këtë rast për shumën e përfutuar, sikurse edhe në raste të tjera, ka ndodhur për shkak të pasqyrimit të gabuar të shumave përkatëse nga zyrat e financës të subjekteve që kryenin pagesat, dokumente, të cilat janë marrë të mirëqena nga ana jonë. Më vonë, duke parë se të dhënat nuk rakordonin me pagesat bankare, është kërkuar rishikimi i tyre, duke u bërë edhe saktësimi rast pas rasti.*

*Këto të ardhura, sqaron subjekti, janë përfutuar nëpërmjet rrugës bankare në llogarinë pranë “Raiffeissen Bank”, me nr. \*\*\* – ALL dhe po të mblidhen kreditimet e SHM-së, rezulton pikërisht kjo vlerë e derdhur përgjatë këtij viti në llogari të bashkëshortit tim, në shumat: në datën 20.7.2011, kredituar shuma 25,200 (njëzet e pesë mijë e dyqind) lekë; në datën 22.7.2011, kredituar shuma 57,600 (pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë; në datën 16.8.2011, kredituar shuma 61,200 (gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë; në datën 16.9.2011, kredituar shuma 7,200 (shtatë mijë e dyqind) lekë; në datën 28.10.2011, kredituar shuma 175,680 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë. Në total, shuma e kredituar si më sipër është ajo e përfutuar nga SHM-ja 326,880 lekë. Për të konfirmuar përfundimisht këto të ardhura, u kërkua nga SHM-ja edhe një vërtetim, në të cilin specifikohet secila pagesë e vitit 2011<sup>58</sup>.*

- *Të ardhura nga Universiteti \*\*\* i Tiranës (U\*\*\*T) në shumën 5,940 Euro (sipas kursit mesatar të BSH konvertuar me 821,502 lekë)*

<sup>57</sup> Konfirmohet nga të dhënat e llogarisë bankare pranë “Raiffeissen Bank”, me nr. \*\*\* – ALL.

<sup>58</sup> Bashkëlidhur gjeni vërtetimin e Shkollës së Magjistraturës.



Referuar deklaramëve të mëparshme për të ardhurat në këtë vit nga U\*\*\*T-ja, subjekti i rivlerësimit sqaron se në deklaratën pas përfundimit të detyrës së hartuar në gusht të vitit 2011, bashkëshorti ka deklaruar si të ardhur me këtë burim, shumën prej 1,800 Euro, kurse në DPV-në për këtë vit, është deklaruar shuma prej 4,800 (katër mijë e tetëqind) Euro, që përfshin edhe periudhën pas muajit gusht 2011. Në fakt, referuar dokumentacionit (të dhënave bankare nga “Credins Bank”), shuma totale e paguar për këtë vit nga U\*\*\*T-ja është 5.940 (pesë mijë e nëntëqind e dyzet) Euro. Edhe në këtë rast, deklarimi gabim i shumës së marrë duhet të jetë si rrjedhojë e referimit po të gabuar nga financa e U\*\*\*T-së. Megjithatë, pas rakordimit me të dhënat bankare dhe dokumentet financiare, si dhe përgatitjes së deklaratës “Vetting”, vetë U\*\*\*T-ja, referuar edhe vërtetimit nr. \*\*\*, datë 25.10.2016 ka ndrequr pasaktësinë, duke pasqyruar shumën 5,940 (pesë mijë e nëntëqind e dyzet) euro për vitin 2011.

Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur kopje të *statement* bankar lëshuar nga “Credins Bank” për llogarinë e bashkëshortit në Euro me nr. \*\*\*, sipas të cilit janë kryer kreditime në shumën prej 990 Euro në datat 10.1.2011; 1.2.2011; 14.2.2011; 26.9.2011; 27.9.2011; 30.9.2011 (totali = 5,940 Euro). Shuma prej 1.140 Euro duhet reflektuar në analizën financiare.

- *Të ardhurat e përfituara nga Universiteti “\*\*\*” në shumën 81.000 (tetëdhjetë e një mijë) lekë.*

Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kjo shumë ka kaluar në llogarinë në lekë, që ka hapur vetë universiteti “\*\*\*\*” në emër të pedagogëve të tij. Konkretisht, llogaria në lekë me nr. \*\*\*, e hapur nga universiteti “\*\*\*\*” figuron në emër të S.S., dhe jo S.S. Në këtë llogari ka kaluar në datën 12.12.2011 shuma prej 81.000 lekësh, si “Honorare dhjetor 2011”, në emër të z. S.S. Në datën 27.12.2011, kjo shumë është tërhequr nga z. S. Shuma e sipërcituar është deklaruar në DPV-në për vitin 2011. Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur *statement*-in e “Credins Bank”, ku pasqyrohet kjo pagesë, si dhe vërtetimi përkatës.

Shuma prej 81.000 lekësh duhet përfshirë në të ardhurat e përfituara nga z. S.S.

- *Të ardhurat e përfituara nga Komiteti \*\*\* , në shumën 1.449 (një mijë e katërqind e dyzet e nëntë) Euro.*

Për vitin 2011, janë përfituar të ardhura në vlerë *bruto* në shumën 1.610 (një mijë e gjashtëqind e dhjetë) Euro dhe pas mbajtjes së tatimit, vlera *neto* është 1.449 Euro dhe në vlerë leku 200.396,7 (dy milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë) Lekë. Të gjitha pagesat janë kryer nëpërmjet BKT-së me çek. Në DPV-në për vitin 2011, kjo shumë është deklaruar me një gabim në shkrim, pasi rezulton e deklaruar “1.450 USD”, por në të vërtetë sikurse rezulton nga dokumentacioni, shuma *neto* e përfituar është 1.449 Euro (rreth 200.396,7 lekë), e cila duhet të llogaritet në të ardhurat e realizuara për këtë vit. Subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2019, lëshuar nga KSHH-ja, ku detajohen pagesat e kryera dhe shuma *bruto* e *neto*, si dhe kopje të mandateve të BKT-së, lidhur me tërheqjet e kryera nga z. S., të këtyre shumave, përkatësisht, të datave 21.12.2011 (1.000 Euro) dhe 27.12.2011 (450 Euro).

- *Të ardhurat e realizuara nga mësimdhënia pranë \*\*\*University (\*\*\*), në shumën 169,650 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë*

Në deklaratën pas përfundimit të detyrës në gusht të vitit 2011, subjekti sqaron se bashkëshorti e ka deklaruar këtë shumë të përfituar (me një gabim të vogël, pasi është deklaruar 169,700 Lekë).

Pagesa e kësaj shume rezulton edhe në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2019, që është lëshuar nga \*\*\*-ja me kërkesë të bashkëshortit (dokumenti bashkëlidhur). Po ashtu, kjo shumë rezulton e derdhur në llogarinë e tij bankare në “Credins Bank” me nr. \*\*\*, në datën 6.7.2011, ndaj duhet të llogaritet në të ardhurat e tij për këtë vit.

- Të ardhurat e përfituara nga \*\*\*, në shumën 175,500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) Lekë.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se gabimisht kjo shumë nuk është deklaruar në DPV-në për vitin 2011, duke qenë një harresë njerëzore e bashkëshortit tim, për shkak të burimeve të ndryshme të të ardhurave. Kjo shumë e përfitur rezulton e gjetur dhe e evidentuar gjatë hetimit dhe vjen nga një burim i ligjshëm. Sipas subjektit, nga ana e bashkëshortit është kërkuar një vërtetim me rastin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë. Nga \*\*\*-i është lëshuar vërtetimi i datës 11.9.2019, ku pasqyrohet pagesa *bruto* në shumën 195,000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë për vitin 2011, ndërkohë që në llogarinë me nr. \*\*\* në “Credins Bank”, në datën 12.4.2011 është kredituar nga \*\*\* shuma *neto* prej 175,500 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekësh.

Në këto kushte, duke qenë një e ardhur e vërtetuar dhe tërësisht e ligjshme, duhet përfshirë në shumën totale të të ardhurave për këtë vit.

*Mbi të gjitha dokumentet e paraqitura, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se: “Nëse mblidhen të ardhurat e evidentuara më sipër, për vitin 2011 rezulton se në total ato janë në shumën 3,779,725 (tre milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë. Nëse kësaj shume, i shtohen edhe të ardhurat e mia si subjekt rivlerësimi prej 750,602 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e dy) lekë, atëherë të ardhurat familjare llogariten në shumën 4,530,327 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë.*

*Nëse do i llogariten kësaj shume edhe të ardhurat e bashkëshortit si autor librash, në shumën 1,200,000 lekë, atëherë shuma në total është 5,730,327 (pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë.”*

145. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të hollësishme edhe në lidhje me shpenzimet për vitin 2011, duke parashtruar disa sugjerime që lidhen me llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit, ndërkohë që për rubrikat e tjera nuk ka parashtruar kundërshtime. Duke marrë në konsideratë udhëtimet e vitit 2011, sikurse janë deklaruar si dhe destinacionin e qëllimin e tyre, subjekti ka dhënë shpjegimet për shpenzimet e bëra në secilin udhëtim, referuar të cilëve shuma e përgjithshme e udhëtimeve për këtë vit nuk rezultonte më e madhe se 3.200 (tre mijë e dyqind) Euro, që llogaritur sipas kursit të kohës së kryerjes së pagesave konvertohen në vlerën 378.759 (treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë. Pra, 162,934 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë më pak nga llogaritja në analizën financiare.

146. Në përfundim, lidhur me analizën financiare për vitin 2011, mbështetur në shpjegimet e mësipërme, subjekti pretendoi se për nxjerrjen e balancës për këtë vit duhet të përfshiheshin në llogaritje të ardhurat dhe shpenzimet e parashtruara. Sipas subjektit, duke marrë në konsideratë të ardhurat në zërat e mësipërm, llogaritur në vlerën 4,530,327 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzet e shtatë) lekë, si dhe shpenzimet në shumën e përgjithshme 3,416,924 (tre milionë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) dhe shtimin e likuiditeteve 1,150,556 (një milion e njëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë, del një rezultat i barabartë me - 37,153 lekë.

147. Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit shoqërues bashkëlidhur, trupi gjykues i gjen të drejta dhe të mbështetura me dokumentacionin provues. Nga analiza financiare e rishikuar, pa marrë në konsideratë të ardhurat nga shitja e librave të z. S.S., rezulton një balancë financiare negative në vlerën 94.937 (nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë për vitin 2011.

| Përshkrimi  |  | 2011 Komisioni    | 2011 Subjekti     | 2011 FINALE Komisioni |
|---|--|-------------------|-------------------|-----------------------|
| <b>PASURI</b>   |  | <b>3 855 956</b>  | <b>3 855 956</b>  | <b>3 855 956</b>      |
| E.+K.   | Apartament trashëguar nga gjyshja, Rr. "****" sip. 55,1 m <sup>2</sup> , shitur më 29.12.2016, vlera: 20,000 euro nga të cilat 10,000 euro kaluar në "Credins Bank" dhe 10,000 euro do të merren deri në mars 2017 | 2 705 400         | 2 705 400         | 2 705 400             |
|   | <i>SHTESA/PAKËSIMI/ LIKUIDITETE</i>  | <i>1 150 556</i>  | <i>1 150 556</i>  | <i>1 150 556</i>      |
|   | <b>TOTAL LIKUIDITETE</b>   | <b>10 390 899</b> | <b>10 390 899</b> | <b>10 390 899</b>     |
| <b>TË ARDHURA</b>                                       |  | <b>6 576 493</b>  | <b>7 235 778</b>  | <b>7 193 360</b>      |
|   | Të ardhura të dokumentuara Edlira Petri  | 750 602           | 750 602           | 750 602               |
|   | Anëtar i Gjykatës Kushtetuese <sup>59</sup> 1998-2011  | 1 221 437         | 1 588 637         | 1 568 128             |
|   | Pagesë kalimtare 2.10.2011-2.10.2014   | 312 120           | 416 160           | 416 160               |
|   | Ekspert Komiteti <sup>60</sup> 2011 750 euro   | 93 352            | 200 397           | 178 488               |
|   | U*** 2008-2016, vlera: 48,078 euro   | 821 502           | 821 502           | 821 502               |
|   | Shkolla e Magjistraturës 1998-2016   | 326 880           | 326 880           | 326 880               |
|   | Të ardhura *** - komentari LPA Kosovë  | 175 500           | 175 500           | 175 500               |
|   | Të ardhura Banka e Shqipërisë, pedagog i jashtëm "**** University"   | 169 700           | 169 700           | 169 700               |
|   | Të ardhura nga universiteti "****"   | 0                 | 81 000            | 81 000                |
|   | TOTAL Të ARDHURA SIPAS VËRTETIMEVE - përfshirë në analizën financiare  | 3 120 491         | 3 779 776         | 3 737 358             |
|   | Trashëguar apartament nga gjyshja  | 2 705 400         | 2 705 400         | 2 705 400             |
| <b>SHPENZIME</b>  |  | <b>3 579 858</b>  | <b>3 432 341</b>  | <b>3 432 341</b>      |
|   | Ndërtim dhe mobilim apartamenti (shitesa M.K.) viti 2011   | 2 000 000         | 2 000 000         | 2 000 000             |
|   | Shpenzime legalizimi shtesë kati sip. 81 m <sup>2</sup>  | 15 957            | 15 957            | 15 957                |
|   | Shpenzime legalizimi apartamenti Qerret  | 68 499            | 68 499            | 68 499                |
|   | Tatim për rivlerësimin e pasurisë "M. K.", sip. 186 m <sup>2</sup>   | 230 083           | 230 083           | 230 083               |
|   | Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së  | 683 100           | 683 100           | 683 100               |
|   | Shpenzime udhëtimi TIMS (nga 2010 SR + BSH dhe fëmijët)  | 541 693           | 394 176           | 394 176               |
|   | Shpenzime AMEX (kartë krediti "Credins Bank") S.S.   | 40 526            | 40 526            | 40 526                |
| <b>DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5-6)</b> |  | <b>-859 322</b>   | <b>-52 519</b>    | <b>-94 937</b>        |

148. Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur, Komisioni vlerëson se bashkëshortët kanë pasur të ardhura për të përballuar plotësisht shpenzimet e tyre. Diferenca negative në shumën **-94 937 lekë**, e llogaritur, pa marrë në konsideratë të ardhurat nga botimi i librave, në vetvete rezulton e papërfillshme. Ky vlerësim mban në konsideratë, jo vetëm shumën e sipërcituar, por edhe balancat e ndjeshme pozitive të pasqyruara në analizën financiare, në periudhat që i paraprijnë dhe pasojnë vitit 2011, çka në zbatim të parimit të proporcionalitetit do të çonte në konkluzionin se ky është një fakt që nuk do të duhej të merrej në konsideratë, në vlerësimin e komponentit të pasurisë për znj. Edlira Petri.

<sup>59</sup> Në bankë kaluar vlera 1,568,128 lekë.

<sup>60</sup> Kursi këmbimit në vlerën 123.8 lekë dhe jo sa e ka llogaritur subjekti në vlerën 138.3 lekë.

Megjithatë, krahas analizës së mësipërme, Komisioni diskutoi edhe për çështjen e ligjshmërisë së të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011, të realizuara nga botimi i librave, duke i vlerësuar të drejta argumentet e parashtruara. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në të ardhurat e tatueshme përfshihen edhe ato të realizuara nga e drejta e autorit (neni 8/ç). Ky ligj, që në nenin 1 të tij, titulluar “Objektivi”, parashikon se synon të rregullojë marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe të tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave. Sipas nenit 33, titulluar “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, parashikohet detyrimi ligjor i subjekteve që kryejnë pagesa me burim edhe të drejtat e autorit (germa “ç”). Ky detyrim nuk zbatohet vetëm kur përfituesi i pagesës ishte vetë një subjekt i regjistruar si tatimpagues (paragrafi 2 i nenit 33). Në rastin konkret, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk rezultoi të ketë qenë i regjistruar si tatimpagues dhe, për rrjedhojë, tatimi për të ardhurat nga botimi i librave, prezumohet të jetë mbajtur nga shoqëria botuese, për sa kohë që sipas të dhënave që disponojnë organet tatimore, shtëpia botuese ka paguar nën zërin “tatim në burim”, sikurse nuk rezultoi që ky subjekt të jetë gjetur në shkelje, lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi. Sjellja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga viti 2012 e në vijim, kur ai ka plotësuar deklaratën DIVA dhe nuk ka vështirësi për të vërtetuar pagesën e tatimit për të ardhurat nga e drejta e autorit, krijon bindjen se edhe për periudhën parardhëse atij i është mbajtur në burim ky tatim, ndërsa aktualisht ka paraqitur të gjitha faktet, të dhënat apo dokumentet që mund të sigurohen si nga vetë përfaqësuesja e subjektit tatimpagues (tashmë jo aktiv), ashtu edhe nga administrata tatimore për aq të dhëna sa ajo disponon.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme.

Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezultoi të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

149. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar një raport në datën 2.11.2017 në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit znj. Edlira Petri. Në vijim, DSIK-ja ka përcjellë informacionin nga SHISH-i, sipas të cilit nuk kishte *indicie* për subjektin e rivlerësimit.

Më tej, raporti nr. \*\*\*, datë 2.11.2017, është deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 24.1.2019.

150. Komisioni ka kërkuar përditësim informacioni lidhur me subjektin e rivlerësimit në agjencitë ligjzbatuese dhe në përfundim nuk ka konstatuar të dhëna apo elementë, të cilët të ngrenë dyshime lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Petri.

151. Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë së Përgjithshme, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2019 informon se nuk ka ardhur asnjë informacion nga agjencitë ligjzbatuese, që të bëjë fjalë për implikim të subjektit të rivlerësimit në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës.

152. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, po ashtu nuk rezultuan të dhëna të dyshimta për këtë subjekt rivlerësimi.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, si dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Petri, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

153. Nga vlerësimi i dosjeve të zgjedhura me short dhe atyre të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se znj. Edlira Petri ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Natyra e çështjeve që subjekti ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme. Një rëndësi të veçantë i kushtohet edhe respektimit ose jo të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta, por nuk janë evidentuar shkelje.

Subjekti i rivlerësimit njeh parimet e përgjithshme të së drejtës, të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton në praktikë. Përdorimi i referencave në jurisprudencën e mëparshme gjyqësore, i vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të drejtave të Njeriut, bëhet rregullisht nëpër vendime apo në dhënien e vendimeve të ndërmjetme.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Petri, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore, përfundimtare, të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Analiza ligjore është e thjeshtë, mjaftohet me tregimin e neneve ligjore të zbatueshme dhe me konkluzionin e zbatimit të tyre, duke përdorur fjali përgjithësuese.

Bazuar në të dhënat statistikore, mesatarja e gjykimit për subjektin Edlira Petri është mbi standardin sasior, vendosur nga KLD-ja.

154. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Edlira Petri (nga data e shortit të çështjet penale dhe civile nga data e seancës së parë të caktuar nga kryetari i gjykatës) ka qenë në intervale kohore nga një ditë (shihni dosjen

nr. 4) deri në 1 muaj e 6 ditë (shihni dosjen nr. 1). Nga këto dy çështje civile janë gjykuar brenda afatit standard, 15 ditë dhe 26 ditë, sipas vendimit të KLD-së, (shihni dosjet nr. 3 dhe 5), ndërsa dosja penale 2 është gjykuar brenda 5 ditëve. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të madhe të gjykimit, prej 1 muaj e 6 ditë ka qenë çështje penale themeli me objekt jo kompleks dhe në përfundim është disponuar me vendim themeli.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 13 ditë (afati më i shkurtër – dosja nr. 5) deri në 3 muaj e 6 ditë (afati më i gjatë – dosja nr. 3).

Ndër pesë dosjet e vëzhguara, 5 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm (shihni dosjet nr. 1-5). Vendimi që është arsyetuar me vonesën prej 3 muajve e 6 ditë, ka qenë çështje civile themeli, me të cilin është disponuar me vendim themeli për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Petri, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e seancës gjyqësore penale (civilët caktohen nga kryetari i gjykatës), ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve pa vonesë nga sekretarja gjyqësore, ndonëse duhet t'i dokumentojë më mirë veprimet e kryera.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura me short, janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në pesë dosjet e vëzhguara, mangësitë janë të njëjta: nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore, ka akte për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, në fashikull nuk përfshihet kopje e listës së shpalljes së seancave gjyqësore për të dokumentuar datën e njoftimit, ndonëse asnjë seancë nuk ka dështuar për këtë shkak, si dhe në fashikull nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për caktimin e datës dhe të orës së seancës gjyqësore.

155. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Edlira Petri, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat<sup>61</sup> informon se subjekti ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë kësaj gjykate për periudhën 21.10.2002 – 30.4.2007 dhe se nga janari 2006 deri më 30.4.2007 nuk rezulton të ketë kërkesa për përjashtimin e subjektit.

Gjykata e Apelit Shkodër<sup>62</sup> informon se për periudhën 30.4.2007 – 7.5.2010 nuk ka të regjistruar çështje me objekt “kërkesë e palëve për përjashtim e subjektit”, përveç rasteve kur subjekti ka hequr dorë nga gjykimi i një çështjeje të caktuar apo përjashtuar me vendim të kryetarit të gjykatës për shkak të pengesave ligjore.

Gjykata e Apelit Tiranë<sup>63</sup> informon se për periudhën 7.5.2010 – 20.2.2019 rezulton se nuk ka pasur asnjë rast kur është pranuar kërkesa për përjashtimin e subjektit.

156. Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019 informon se në bazë të informacioneve periodike që kryetarët e gjykatave raportojnë pranë KLD-së, Inspektorati i këtij të fundit ka nxjerrë një vendim për fillimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë së gjyqtares Edlira Petri, konkretisht: vendimin nr. \*\*\*, datë 29.3.2017, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtares së Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri”. Për këtë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur në dispozicion të Komisionit dosjen e plotë të këtij hetimi disiplinor.

<sup>61</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2019.

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2019.

<sup>63</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2019.

Nga praktika e dërguar nga KLGj-ja rezulton se në raportimin periodik lidhur me problematikat e gjykatave për muajin dhjetor 2016, nga kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë është raportuar lidhur me vendimet e dorëzuara me vonesë tej afatit 30-ditor, konkretisht 5 vendime.

Nga veprimet hetimore dhe nga provat e mbledhura gjatë hetimit disiplinor është konstatuar se nga ana e subjektit nuk janë respektuar afatet procedurale civile për dorëzimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara, konkretisht janë 5 vendime gjyqësore të dorëzuara me vonesë: vendimi nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, vendimi nr. \*\*\*, datë 17.11.2016, vendimi nr. \*\*\*, datë 15.11.2016, vendimi nr. \*\*\*, datë 24.11.2016 dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 24.11.2016.

Referuar afatit 30-ditor të së drejtës së ushtrimit të rekursit nga palët ndërgjyqëse për këto vendime të kontrolluara, tejkalimet e afateve rezultojnë të jenë mes 24 ditë deri në 2 muaj e 3 ditë. Duke pasur parasysh që koha e dhënies së vendimeve gjyqësore ka qenë në fund të vitit dhe të gjitha vendimet janë dorëzuar në muajt e parë të vitit pasardhës në tejkalimin e afateve mbahen në konsideratë edhe pushimet vjetore të kryera. Sipas Inspektoratit të KLD-së, nga analiza e vendimeve, në asnjë rast nuk rezulton të kenë qenë të natyrës komplekse, që të justifikonte vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Inspektorati i KLD-së ka pasur në konsideratë rrethanat e parashikuara nga kryetari i Gjykatës së Apelit z. H.D., i cili shpjegoi se raporti i përcjellë nuk është i natyrës problematike dhe se subjekti ka pasur ngarkesë të lartë në punë në muajin dhjetor 2016, si dhe ngarkesa për shkak të qenies anëtare e kolegjit zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Gjatë hetimit të KLD-së subjekti ka parashtruar, ndër të tjera, se shkak për vonesat është bërë ngarkesa e lartë në punë, si dhe fakti që sekretarja gjyqësore ka pasur një problem familjar dhe ka qenë me leje.

Inspektorati i KLD-së ka përfunduar hetimin disiplinor për mosrespektim formal të ligjit duke konkluduar se ka pasur vonesa të dukshme në dorëzimin e vendimeve gjyqësore, të arsyetuara, duke sjellë kështu mosrespektimin formal të ligjit procedural në këtë drejtim nga subjekti. Inspektorati ka çmuar që rezultatet e hetimit disiplinor t'i përcillen Këshillit të Lartë Gjyqësor, në momentin e krijimit të tij në kuadër të vlerësimit etiko-profesional të subjektit për t'u evidentuar si një e dhënë statistikore në këtë vlerësim, pasi shkelja nuk rezulton të ketë qenë e kryer me qëllim apo për shkak të neglizhencës në ushtrimin e detyrës nga subjekti.

157. Komisioni ka vërejtur vonesa në dhënien e vendimit të arsyetuar. Bazuar në statistika, justifikohet ideja se kjo duhet të ketë ndodhur edhe në çështje të tjera që subjekti i rivlerësimit ka gjykuar. Nga hetimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për këtë çështje në vitin 2015 (shiko f. 49 të raportit) rezulton vërtetë se në pothuajse 50 % të çështjeve, subjekti i rivlerësimit, në këtë drejtim ka shkelur afatet ligjore të parashikuara.

158. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimi të japë sqarime për mënyrën dhe organizimin e punës, menaxhimin e kohës, mënyrën e bashkëpunimit me stafin e saj ndihmës, si dhe pikëpamjet për dhënien e drejtësisë në kohë, si një element i cilësisë së drejtësisë dhe sigurisë juridike. Gjithashtu, i kërkoi të shpjegojë nocionin mbi ndikimin e këtyre vonesave të vazhdueshme në procesin e punës së partnerëve të tjerë në procesin gjyqësor, siç është administrata gjyqësore, gjykatat e tjera/të larta/të ulëta, si dhe palët e përfshira në proces.

159. Në shpjegimet e saj, subjekti ka sqaruar se: *“Nga të dhënat e raportit për përfundimin e hetimit në aspektin e vlerësimit profesional, konstatoj, paraprakisht, se jam vlerësuar duke marrë në konsideratë vendimet, ku kam pasur cilësinë e relatores së çështjes, që në total, për të gjithë periudhën e rivlerësimit janë 1066 të tilla (këtu nuk janë llogaritur 50 çështje të gjykuara në vitin 2014 me komandim në Gjykatën Administrative të Apelit). Në vijim, referuar pikërisht këtij numri vendimesh dhe periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, në raport konstatohet se*

*'mesatarja e gjykimit për subjektin Edlira Petri është 203 çështje civile dhe penale në vit (mbi standardin sasior të vendosur nga KLD-ja).'*

*Më lejoni të evidentoj se bazuar në të dhënat e mësipërme, mesatarja e vendimeve të dhëna në një vit si relatore, nuk është 203, por 355 çështje në vit. Diferenca nuk është e vogël, ndaj do të doja ta evidentoja si një të dhënë statistikore të rëndësishme, të nevojshme, por edhe thelbësore, që ndihmon për të vlerësuar në tërësi, aspektin profesional të veprimtarisë time gjyqësore. Në këtë shifër nuk përfshihet ngarkesa e punës, që vjen për shkak të shumë çështjeve që kam qëndruar në pakicë (vetëm për vitin 2016 kam shkruar rreth 55 mendime pakice dhe paralele <sup>64</sup>).*

*Veç sa më sipër, konstatoj se për vlerësimin tim profesional, nuk janë marrë në konsideratë numri i çështjeve të gjykuara, ku unë kam marrë pjesë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Është e paqartë për mua se përse KLD-ja ka vendosur këtë metodë, ndërsa konstatoj se për gjyqtarët e Gjykatës së Krimeve të Rënda, në numrin e çështjeve të gjykuara, janë përfshirë edhe ato çështje, ku gjyqtarët kanë qenë anëtarë të trupit gjykues. Nuk e mendoj si zgjidhje të drejtë përdorimin nga KLD-ja të standardeve të ndryshme për gjyqtarët.*

*Sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë (bashkëlidhur), rezulton se për të gjithë periudhën e rivlerësimit kam marrë pjesë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues në 1,684 gjykime (pa llogaritur urdhrat e mbrojtjes dhe njohjet e vendimeve të gjykatave të huaja, vendimet e Kolegjit Zgjedhor, si dhe 100 çështje pranë Gjykatës Administrative të Apelit). Mesatarisht, llogariten 561 vendime në vit, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues.*

*Nga një llogaritje e kalendarit të punës për periudhën e rivlerësimit rezultojnë në total, 669 ditë pune (ose mesatarisht 223 ditë pune në vit), nga të cilat, për vitin 2013 (nga data 8 tetor) janë 45 ditë pune; për vitin 2014 janë 227 ditë pune; për vitin 2015 janë 227 ditë pune dhe për vitin 2016 (deri në datën 8 tetor) janë 170 ditë pune.*

*Mesatarisht, llogaritet se gjatë periudhës së vlerësimit, si relatore, të kem gjykuar, dhënë vendime dhe më pas arsyetuar rreth 1,59 vendime për çdo ditë pune, plus edhe gjykuar 2,5 çështje në ditë, si anëtare e trupit gjykues. Kjo shifër nuk llogarit rastet kur si anëtare e trupit gjykues kam qenë në pakicë dhe kam qenë e detyruar të shkruaj mendimin tim.*

*Pra, gjatë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, nga data 8.10.2013 deri më 8.10.2016 20:*

*si relatore kam dhënë gjithsej 1066 vendime, me një mesatare prej 355 vendime (çështje) në vit; në cilësinë e anëtares së trupit gjykues kam marrë pjesë në 1,684 gjykime, me një mesatare prej 561 vendime në vit.*

*Nëse mbahet parasysh se në Gjykatën e Apelit Tiranë, të paktën 2 nga 5 ditë në javë, janë të planifikuara për të zhvilluar seancat gjyqësore (megjithëse gjyqtarët shpesh angazhohen në gjykime edhe në ditë të tjera të javës), atëherë nga 223 ditë pune në vit, rreth 89 ditë pune janë të caktuara vetëm për seancat gjyqësore. Pjesa tjetër, prej 134 ditë pune në vit, mbetet për të kryer të gjithë procesin e studimit të dosjeve, si edhe të shkrimit dhe arsyetimit të rreth 355 vendimeve. Pra, mesatarisht numri i çështjeve që duhen studiuar dhe arsyetuar vendimet është 2,6 çështje në ditë.*

*Duke qenë se çështja e afatit të arsyetimit të vendimeve më vihet në dukje dhe është evidente se përbën problematikën kryesore në kuadër të vlerësimit tim profesional, më poshtë duke marrë në konsideratë edhe të dhënat dhe analizën e sipërtrajtuar, do të parashtroj qëndrimin tim në një çështje më vete dhe më të detajuar, ku do të përmend edhe rastet specifike.*

---

<sup>64</sup> "Për shkak të afatit për kthimin e përgjigjes, situatës në vend dhe reduktimit të stafit të administratës gjyqësore, e pata të pamundur të evidentoj të gjitha rastet kur unë kam qenë në pakicë".



*Mbi vonesën në arsyetimin e vendimit, subjekti shpjegon sa vijon: sikurse kam parashtruar edhe më lart, e pranoj se kjo problematikë ekziston dhe realisht është një fakt që më bën të ndihem jo mirë, ndonëse sikurse do të parashtroj më poshtë, ka qenë objektivisht e pamundur, që afatet e kërkuara të zbatohen me përpikmëri, veçse nëse do të cedoja në komponentët e tjerë të punës sime. Në fakt, evidentohet se numri i çështjeve të gjykuara është shumë më i lartë nga standardi sasior i përcaktuar nga KLD-ja, standard ky që nënkupton edhe mundësitë objektive për ngarkesën në punë të gjyqtarit. Për rrjedhojë, tejkalimi i ngarkesës standard, prezumon edhe tejkalimin e kohës së punës, që konsiderohet e arsyeshme për një gjyqtar. Fatkeqësisht, koha e punës është gjithnjë e njëjtë, ndaj brenda saj gjyqtarit do t'i duhet të përmbushë të gjitha detyrimet e tij, duke bërë maksimumin.*

*Parimisht, duke marrë në konsideratë të gjithë elementet që, sipas eksperiencave më të mira ndërkombëtare dhe sipas legjislacionit tonë të brendshëm, merren në konsideratë për vlerësimin e gjyqtarit dhe që përfshijnë të gjithë procesin e tij të punës, një vend të rëndësishëm e zënë edhe aftësitë organizative të tij, e në këtë kuptim eficienta në punë. Ky kriter vlerësues lidhet drejtpërdrejt edhe me garancitë për zhvillimin e një procesi gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, si një ndër komponentët e procesit të rregullt. Sa më shumë të zgjatet zbardhja e vendimit, aq më vonë, pala që ka fituar një të drejtë, do ta ekzekutojë atë, sikurse pala që ka humbur gjyqin do të mund të gjykohet nga një gjykatë më e lartë. Praktikisht, sa i përket mundësisë për të parashtruar shkaqet e ankimit, pala që synonte të bënte ankim/rekurs, lejohej të depozitonte në sekretari një ankim të shkurtuar dhe kur njihej me vendimin e arsyetuar, ai depozitonte edhe shkaqet konkrete të ankimit/rekursit. Megjithatë, çdo vonesë në zbardhjen e vendimit të gjykatës, ndikon në zgjatjen e afatit të përmbjlljes së procedurës gjyqësore dhe për rrjedhojë, në të drejtën e palëve për gjykim brenda afateve të arsyeshme.*

*Mund të them se përherë jam orientuar nga standardet që lidhen me organizimin dhe menaxhimin e kohës, në mënyrë të veçantë nga aktet e CEPEJ (Komisioni European për Eficiencën e Drejtësisë). Përkufizimi se 'kohëzgjatja e procedimeve gjyqësore është ajo kohëzgjatje, e cila mund të përkufizohet si një triologji qëllimesh për sistemet gjyqësore, funksionimi i të cilave duhet të jetë: i drejtë, i përballeshëm dhe në një kohë të arsyeshme'<sup>65</sup> tregon për rëndësinë e harmonizimit të kohës gjyqësore (pjesë e afatit të arsyeshëm) me cilësinë e dhënies së drejtësisë, përfshirë edhe cilësinë e një vendimi gjyqësor bindës dhe të argumentuar.*

*Vonesa në dorëzimin e vendimit të arsyetuar nuk duket të jetë një problematikë e kufizuar në gjyqtarë të veçantë. Nga burimet e hapura të informacionit, sikurse janë edhe studimet e kryera nga institute jopublike, ky fenomen rezulton evident edhe në vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, ndonëse ata asistohen nga këshilltarë ligjorë dhe staf ndihmës<sup>66</sup>.*

*Për gjithë sa më sipër, unë jam tërësisht e vetëdijshme për rëndësinë që ka shpejtësia në zbardhjen e një vendimi gjyqësor dhe ndonëse ky pohim duket sikur nuk përputhet me realitetin e evidentuar nga ju, më duhet të shpjegoj rrethanat dhe arsytet e kësaj situate.*

*Fillimisht vë në dukej se zbardhja e një vendimi gjyqësor është faza finale e një procesi në gjykatën përkatëse, së cilës i paraprin procesi i studimit të dosjes dhe ai i seancës dëgjimore. Këto faza kërkojnë gjithashtu shpenzim kohe dhe energjie.*

*Një ndryshim pozitiv në legjislacion është se fillimi i afatit të ankimit për palët nis nga dita e komunikimit të vendimit të arsyetuar, duke lehtësuar procedurat edhe për palët, edhe për administratën gjyqësore.*

*Si konkluzion, duke qenë se jam vlerësuar pozitivisht në aspektin e vlerësimit, lidhur me kriteret e aftësive profesionale, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit, aftësive*

<sup>65</sup> Miratuar në takimin datë 7.12.2016, të CEPEJ.

<sup>66</sup> Shihni për këtë linkun [www.gjykataehapur.al](http://www.gjykataehapur.al)

*personale dhe angazhimit profesional, si dhe aftësive organizative në aspektin e zhvillimit të procedurës së gjykimit, do të doja që vlerësimi i aftësive organizative, lidhur me shpejtësinë e arsytimit të vendimeve, të kryhej duke marrë në konsideratë sa ngarkesën shumë të lartë në punë, ashtu edhe peshën që zë ky nën kriter i aftësive organizative, në tërësinë e kriterëve vlerësues të gjyqtarit.*

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

Në vlerësim të aftësive profesionale të znj. Edlira Petri, bazuar në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, trupi gjykues çmon se znj. Petri ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, si dhe ka respektuar të drejtat e palëve. Subjekti ka treguar aftësi për të marrë vendime gjyqësore nëpërmjet interpretimit të drejtë të ligjit. Në çështjet e vlerësuara vërehet se vendimet përmbajnë tregues të tillë si: qartësia dhe kuptueshmëria e tyre, si dhe me strukturë të qëndrueshme. Vendimet kanë në përmbajtje analizë dhe argument logjik.

Në vlerësimin e aftësive organizative janë evidentuar vonesa në zbardhjen e vendimeve, të cilat duket se kanë ardhur për shkak të ngarkesës në punë dhe disa rrethanave, që nuk varen tërësisht nga gjyqtarja.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se mbështetur në treguesit e vlerësimit të aftësive profesionale sipas neneve 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, si dhe vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të kreut VI të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Petri, ka arritur nivelin kualifikues të kërkuar në vlerësimin e aftësive profesionale dhe konsiderohet “i aftë”.

### **DENONCIMET E PUBLIKUT**

160. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Edlira Petri, janë regjistruar 10 denoncime në Komisionin, pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është paraqitur një denoncim, ndërsa nga kërkimet *online* është marrë një *indicie*, të cilat janë trajtuar më poshtë, të detajuara.

1. Denoncim i shtetasit V. Ç., përcjellë në Komision nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2019. Z. V. Ç., ka denoncuar 12 subjekte, ndër të cilët dhe subjektin e rivlerësimit. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga denoncuesi, rezulton se ka paraqitur kallëzim në datën 6.6.2017 dhe në datën 16.6.2017 ndaj subjektit të rivlerësimit dhe ndaj tri subjekteve të tjerë, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Shtetasi V.Ç., ka kallëzuar subjektin, pasi ka qenë relatore në trupin gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili, në datën 13.7.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së denoncuesit për përjashtimin e dy gjyqtarëve të trupit gjykues që gjykonte çështjen e tij.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2017 për veprën penale të shpërdorimit të detyrës për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.3.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. \*\*\*, datë 23.3.2018.

▪ Pas analizimit të denoncimit, duket se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

2. Denoncim nga shtetasi M.C., dhe fëmijët e tij, i regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019. Denoncuesi ankohet mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit si kryesuese e Kolegjit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Sipas ankimit, denoncuesi, në datën 5.2.2006 ka humbur bashkëshorten si pasojë e një aksidenti automobilistik, ku shkaktar ishte shtetasi A. K., me profesion polic me automjetin e pasiguruar. Denoncuesi shprehet se Byroja Shqiptare e Sigurimit ka vendosur vlerën e dëmshpërblimit në vlerën 1.465.291 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë, por gjyqtarja nuk bëri asnjë pagesë të dëmshpërblimit me justifikimin se palët janë rregulluar me njëra-tjetrën. Në këto kushte, z. M.C., paraqiti kërkesë-padinë në datën 30.4.2010. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.2013, vendosi ndër të tjera, detyrimin e Byrosë në vlerën 6.044.228 (gjashtë milionë e dyzet e katër mijë e dyqind e njëzet e tetë) lekë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë, me kryesues subjektin e rivlerësimit, vendosi detyrimin e Byrosë për të paguar vlerën 1.468.291 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një) lekë si dhe kamatëvonesat.

Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se e drejta e tyre është parashkruar pasi kanë kërkuar ndryshimin e objektit të padisë në vitin 2013.

Pretendimi i denoncuesit lidhet ngushtësisht me zbatimin e ligjit në rastin e veprimit të institutit të parashkrimit shues të padisë. Kjo është një çështje ligji dhe e drejta e pretenduar, si e cenuar nga denoncuesi mund të zgjidhet nëpërmjet rekursit dhe dhënies së argumenteve se përse padia e tij nuk ishte parashkruar dhe si e tillë duhej të ishte marrë në shqyrtim.

Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja civile objekt i vendimeve gjyqësore të mësipërme.

3. Denoncimi i paraqitur nga shtetasi M.D., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2018 kundrejt subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Petri, dhe dy subjekteve të tjerë. Denoncuesi ankohet për njëanshmëri dhe bashkëlidh kërkesën drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, “për përjashtimin e trupit gjykues Edlira Petri, relatores, dhe gjyqtarët I.T., dhe A.M”, pasi nuk kanë pranuar kërkesën e tij për pezullimin e procesit gjyqësor deri në përfundimin e hetimit të kallëzimit penal dhe përfundimit të gjykimit të çështjes administrative.

Subjekti shpjegon se: *“Në vijim, avokati i palës i kërkoi Gjykatës së Apelit të pezullonte çështjen, sepse kishte paraqitur ndaj palës tjetër kundërshtare një kallëzim penal dhe kishte iniciuar një gjykim në Gjykatën Administrative. Gjykata e Apelit e gjeti të pabazuar kërkesën për pezullim, çka përbën edhe shkakun e denoncimit ndaj meje. Në vijim, pasi të paditurit M.D., iu bë me dije se seanca e ardhshme gjyqësore nuk do të shtyhej më për asnjë arsye, që lidhej me mungesën e mbrojtësit, ditën e gjykimit, ai dhe avokati i tij nuk u paraqitën. Në përfundim, gjykata dha vendimin, i cili ishte në favor të z. M.D”.*

▪ Pas analizimit të denoncimit, duket se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

4. Denoncim i shtetases Sh.V., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2017. Denoncuesja ankohet mbi vendimmarrjen e trupës së Gjykatës së Apelit Tiranë, ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.10.2015, vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë së ngritur nga paditësja N.V etj., me të paditur z. R.H etj. me objekt “shfuqizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 16.2.1995, të KKP-së Tiranë. Shfuqizim i vendimit të KKKP-së Tiranë nr. \*\*\*, datë 13.10.1993, vendimit nr. \*\*\*, datë 13.10.1993”.

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë, në përbërje të të cilit është edhe subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2017, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 26.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezultojnë e regjistruar çështja civile me objekt “shfuqizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 16.2.1995, të KKP-së Tiranë. Shfuqizim i vendimit të KKKP-së Tiranë nr. \*\*\*, datë 13.10.1993, vendimit nr. \*\*\*, datë 13.10.1993”, me paditës Sh. V etj., dhe i paditur AKKP Tiranë, z. R.H.

▪ *Pas analizimit të denoncimit, duket se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.*

5. Denoncim i shtetasës K.Dh.K., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2018. Denoncuesja ankohet për subjektin e rivlerësimit, pasi si anëtare e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit ka dhënë një vendim bazuar në një kontratë dhurimi të falsifikuar, si dhe më pas në shitjen e pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme dhe ky vendim mund të lidhet vetëm me korrupsionin në trupit gjykues. Sipas denoncueses kundërvajtësit kanë siguruar mjete të mjaftueshme financiare, të cilat nuk do t’i kursenin për korrupsionin e gjyqtarëve. Nga shqyrtimi i vendimit të Gjykatës së Apelit nr. \*\*\*, datë 28.9.2016, rezultojnë se subjekti ka qenë kryesuese e trupit.

Sipas ankimit, denoncuesja në datën 7.11.2019 ka depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe janë në pritje të shqyrtimit nga ana e kësaj gjykate të çështjes gjyqësore në fjalë. Denoncuesja bashkëlidh rekursin.

▪ *Pas analizimit të denoncimit, duket se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.*

6. Denoncim i shtetasit G.Sh., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2018. Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe dy subjekte të tjerë, pasi kanë dhënë vendim në kundërshtim flagrant me ligjin. Denoncuesi është përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe ka pasur një proces gjyqësor me shoqërinë OSHEE, pasi sipas pretendimit të z. G.Sh., në mënyrë korruptive dhe tendencioze kanë mbifaturuar shoqërinë që përfaqëson. Denoncuesi nuk i bashkëlidh vendime gjyqësore ankesës. Shtetasi G.Sh., ka depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë një kallëzim penal ndaj subjektit dhe dy gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Apelit për kryerjen e veprës penale “shpërdorim i detyrës”. Ky kallëzim është trajtuar më lart.

Subjekti sqaron se: “Nuk po ndalem tek ky rast, pasi e ndjerë thellësisht e fyer për disa cilësi specifike të z. G.Sh., i cili ka bërë edhe gjykime të tjera dhe nuk ka hezituar që sa herë humbiste gjykimet, të përgojonte gjyqtarët e t’i kallëzonte ata edhe unë e kam kallëzuar atë për veprën penale ‘fyerje e gjyqtarit’. Ende nuk më kanë njoftuar se si vijon procesi, por bashkëlidhur do të gjeni një kopje të kallëzimit që unë dhe një nga anëtarët e trupit gjykues kemi bërë ndaj z. G.Sh.”<sup>67</sup>.

Nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezultojnë se në datën 26.2.2019 është regjistruar çështja civile me nr. \*\*\*, me palë shoqërinë “OSHEE” sh.a., dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

▪ *Pas analizimit të denoncimit, duket se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.*

7. Denoncim i shtetasit F.L., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018. Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe dy subjekte të tjerë, pasi kanë dhënë vendim të kundërligjshëm. Sipas denoncuesit, trupi gjykues ka zhvilluar gjykimin në mënyrë të fshehtë sepse nuk janë thirrur në proces. Z. L., pretendon se gjyqtarët kanë administruar prova false dhe e kanë dhënë

<sup>67</sup> Anëtarë i tretë nuk ishte më gjyqtar në kohën kur u bë kallëzimi.

vendimin për afere korruptive dhe se janë dhënë vlera të mëdha për këtë vendim. Nga shqyrtimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 30.9.2010, ku subjekti i rivlerësimit është anëtare rezultoi se:

Paditës: Ll.L., M.L.(L.), D.Th.(L.), K.L., D.Gj.(L), Gj.L., L.L., M.M.(L.), D.L., A.L., P.L., V.L.

I paditur: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë; Avokatura e Shtetit.

Palë e tretë: Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Lezhë.

Vihet re se denoncuesi nuk ka qenë pjesë në procesin gjyqësor të zhvilluar përpara Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, denoncuesi nuk paraqet asnjë provë për të vërtetuar aferat korruptive të gjyqtarëve.

- Pas analizimit të denoncimit, duket se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr .84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

8. Denoncim i shtetasit A.Ç., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018. Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe për 6 subjekte të tjerë. Denoncuesi ankohet për gjyqtarët e të gjitha shkallëve të gjyqësorit, pasi kanë dhënë vendime të padrejta kundrejt vajzës së tij. Denoncuesi shpjegon se ka 10 vjet në proceset gjyqësore dhe se nuk kanë përfituar asgjë nga kompania “\*\*\*\*” për vdekjen e dhëndrit gjatë aksidentit automobilistik në furgonin e linjës.

Denoncimi i shtetasit A.Ç., për vendim të padrejtë përbën një çështje që duhet të shqyrtohet nga gjykatat, sipas hierarkisë së tyre.

- Pas analizimit të denoncimit, duket se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

9. Denoncim i shtetasit V.Ç., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017. Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit, pasi trupi gjykues i Gjykatës së Apelit me në krye znj. Edlira Petri kanë zhdukur rreth 50 prova.

- Pas analizimit të denoncimit, duket se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

10. Denoncim i shtetasit M.Z., regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018. Denoncuesi, ndër të tjera, kërkon verifikimin e ligjshmërisë dhe procesin e rregullt ligjor në dhënien e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\*, datë 21.4.2014.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit konstatohet se përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është zhvilluar çështja gjyqësore me:

Paditës: M.T. (Z.), A.Zh., M.Z.

I paditur: E.K.

Person i tretë: Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë.

Objekti: konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës noteriale, nr. \*\*\*, datë 2.3.1998 etj.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.3.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë.

Trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë në të cilën subjekti është anëtare me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.2.2017, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditëset M., A., dhe M.Z., kundër vendimit të Apelit nr. \*\*\*, datë

21.4.2014. Gjykatës Kushtetuese i është paraqitur kërkesa për shfuqizim si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.2.2017.

Nga kërkitimi *online* rezulton se në fletoren zyrtare nr. 30, të vitit 2018 është botuar vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. \*\*\*, datë 2.3.2018, me të cilin është vendosur rrëzimin e kërkesës.

▪ Pas analizimit të denoncimit, duket se në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

11. Pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është paraqitur një denoncim anonim, ku denoncuesi shprehet se është gjyqtar i Gjykatës së Apelit Shkodër në proces rivlerësimi nga Komisioni. Denoncuesi, ndër të tjera, ankohet për subjektin e rivlerësimit sepse është korrupsuar në çështjen e shtetasit A.V., i cili është dënuar për vrasje nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Sipas denoncimit, në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje subjekti ishte në Gjykatën e Apelit Shkodër. Për këtë çështje është nisur procedim penal ndaj avokatit të shtetasit A.V., z. S.U.

11.1 ONM-ja e ka përcjellë për verifikime në Komision<sup>68</sup> dhe për këtë denoncim janë kryer veprimet hetimore të mëposhtme:

a) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i janë kërkuar fashikujt e procedimit penal \*\*\*, pjesë e dosjes gjyqësore, që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 22.5.2013, në ngarkim të shtetasit S.U.

b) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është kërkuar dosja gjyqësore që i përket vendimi me nr. \*\*\*, datë 22.5.2013, në ngarkim të shtetasit S.U., të cilën gjykata e vendos në dispozicion të Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2019.

c) Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i është kërkuar dosja gjyqësore që i përket shtetasit A.V. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>69</sup> vendos në dispozicion kopje të dosjes gjyqësore, që i përket vendimit penal nr. \*\*\*, datë 13.7.2009.

ç) Këshillit të Lartë Gjyqësor i është kërkuar vendimi i transferimit të gjyqtares Edlira Petri nga Gjykata e Apelit Shkodër në Gjykatën e Apelit Tiranë, si dhe vendimi i komandimit të subjektit për ndjekjen e disa çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Shkodër edhe pas transferimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2019, vendos në dispozicion të Komisionit:

d) Vendimin nr. \*\*\*, datë 7.5.2010, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për transferimin e gjyqtares Edlira Petri nga Gjykata e Apelit Shkodër në Gjykatën e Apelit Tiranë.

dh) Vendimin nr. \*\*\*, datë 2.6.2010, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me të cilin vendoset që znj. Edlira Petri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë të caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër për 4 çështje, ndër të cilat dhe çështjen penale në ngarkim të të pandehurit A.V., i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/dh e 278/2 të Kodit Penal.

<sup>68</sup> Nga kërkitimi *online* rezulton se Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.10.2013 ka vendosur mbi kërkesën e z. A.V., me objekt “Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; vendimit nr. \*\*\*, datë 28.3.2011 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr. \*\*\*, datë 26.12.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese rezulton se:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2009 deklaroi fajtor shtetasin A.V., për kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese kundër dy ose më shumë personave”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 79/dh, 22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 24 vjet burgim si dhe për veprën penale “Mbajtje pa leje të armëve luftarakë” duke e dënuar me 3 vjet burgim. Në aplikim të bashkimit të dënimeve shtetasi A.V., është dënuar me 25 vjet burgim.

Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.3.2011 ka vendosur “lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2012 ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i gjykuari A.V., nëpërmjet përfaqësuesit të tij kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 28.3.2011, të Gjykatës së Apelit Shkodër”.

<sup>69</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2019.

e) Është bërë shkresë pranë organeve ligjzbatuese për informacione të nevojshme që mund të disponojnë për subjektin e rivlerësimit. Nga përgjigjet e përcjella nuk ka pasur *indicie* për subjektin e rivlerësimit.

ë) Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit mbi datën kur ka paraqitur dorëheqjen nga çështja, si dhe mbi faktin se si janë caktuar seancat në periudhën shtator - dhjetor kur nga muaji shtator 2010 e në vijim rezultoi me raport (leje barrë lindje). Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë çdo informacion/sqarim tjetër të nevojshëm lidhur me këtë çështje. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se:

*“Mbaj mend se kam shkuar disa herë në Gjykatën e Apelit Shkodër, por për arsye të ndryshme, që nuk lidhen në asnjë rast me mua, nuk u arrit që gjykimi të zhvillohej, derisa pas pushimeve të muajit gusht dhe, konkretisht, në muajin shtator të atij viti, unë kisha hyrë në muajin e nëntë të shtatzënisë. Në këto rrethana ishte objektivisht e pamundur, që të udhëtoja për të zhvilluar gjykimin në Shkodër. Për rrjedhojë, që në këtë kohë, unë i kam kërkuar kryetarit të Gjykatës së Apelit Shkodër të miratojë dorëheqjen time, pasi shërbimi im nuk do të ishte më i disponueshëm, të paktën për 12 muaj të tjerë (sa zgjat leja e barrë lindjes). Gjykimi i çështjes, në raste të tilla, nuk mund të pezullohet për shkak të raportit të lindjes së gjyqtarës. Për shkak të rrethanave, në të cilat ndodheshin në këtë periudhë, por edhe të paraqitjes së dorëheqjes nga çështja, unë nuk kam shkuar më në Gjykatën e Apelit Shkodër. Çdo shtyrje e seancave gjyqësore (rezultoi se janë shtatë të tilla), por edhe shkak i shtyrjes së tyre (leja e lindjes e gjyqtarës) duhet të jenë bërë me dije nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, ashtu sikurse duhet të jenë urdhëruar edhe njoftimet për çdo seancë. Kjo gjë duhet të jetë e verifikueshme lehtësisht edhe nga dosja gjyqësore, ku prezenca ime rezultoi të jetë ndërprerë në muajin shtator 2010.*

*Nga ana tjetër, nuk jam në gjendje t’ju jap asnjë shpjegim se përse dorëheqja ime qenka shqyrtuar dhe pranuar vetëm në fund të muajit dhjetor 2010. Kjo është një çështje që del jashtë vullnetit tim, përderisa, sipas ligjit, i përkiste ta zgjidhte me kohë kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër. Shtatzënia ime dhe fakti i marrjes së lejes së barrë lindjes ishin një fakt i njohur për të gjithë kolegët. Për mua është e pakuptueshme, por edhe e pa tolerueshme njëkohësisht për trupën gjyqësore, si dhe për mënyrën e administrimit të dosjeve nga Gjykata e Apelit Shkodër se, përse janë zhvilluar shtatë seanca gjyqësore me përshkrimin se nuk formohet trupi gjykues dhe nuk është kërkuar plotësimi i trupës me një tjetër gjyqtar, ndërkohë që gjyqtarja relatore ishte me leje barrë lindje.*

*Lidhur me shpjegime apo sqarime të tjera mbi këtë çështje, më lejoni t’ju them se me këtë rast, kam bërë detyrën time edhe si qytetarë, kur jam thirrur dhe jam pyetur në Prokurori dhe në Gjykatë, në çështjen penale kundër z. S.U. Si gjyqtarë, ndjehem e neveritur për faktet që i mësova nga vendimet gjyqësore penale, të dhëna për të akuzuarit dhe e keqardhur për mjedisin, ku ne e ushtrojmë detyrën”.*

■ *Pas analizimit të denoncimit, duket se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.*

12. Një informacion<sup>70</sup> mediatik ka bërë me dije se Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë një nga vendimet më të çuditshme, duke rrëzuar kërkesën e drejtësisë italiane për të ekstraduar “baronin” G.Ç., i dënuar në vendin fqinj me 20 vjet burg. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Tiranës është dhënë nga treshja e gjyqtarëve A.H., kryesues dhe anëtarët Edlira Petri dhe Sh.M., të cilët liruuan nga burgu shtetasin G.Ç.

<sup>70</sup><https://www.gazeta-shqip.com/2014/06/14/ministria-e-drejtësisë-dhe-apeli-tiranës-liruan-c-10-dite-pas-zgjedhjeve-2013/>

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se treshja e gjyqtarëve A.H., kryesues dhe anëtarët Edlira Petri dhe Sh.M., kanë marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 2.7.2013, ku gjyqtarja Edlira Petri ka paraqitur një mendim pakice, ku ka argumentuar se shtetasi G.Ç., duhet të ishte liruar.

Në përfundim të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me ligjshmërinë e këtij vendimi në raport me denoncimin mediatik.

Znj. Edlira Petri ka shpjeguar në vijim të shpjegimeve se: *“Duhet evidentuar se denoncimi mediatik strukturohet në mënyrë të tillë që fillimisht tregon disa fakte që përgjithësisht janë të vërteta, me përjashtim të faktit se shtetasi G.Ç., u lirua nga burgu, ndërkohë që ai ishte me masën e sigurimit ‘arrest në shtëpi’. Shkrimi fillon me tregimin e faktit se një letër porosi e kërkuar nga Gjykata e Tiranës nuk ishte ekzekutuar nga Ministria e Drejtësisë, sikurse tregon edhe pretendimet e mbrojtësit të shtetasit G.Ç., që lidheshin me një kusht pengues për ekstradimin, siç është dënimi i Ç., për të njëjtin fakt me vendim të gjykatës shqiptare (ne bis in idem). Në fakt, këto janë dy rrethana mjaft thelbësore, hetimi i të cilave nxjerr të vërtetën e kësaj çështjeje.*

*Në vijim, shkrimi përmban opinionin se vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Tiranë ishte një nga më të çuditshmit, dhe pasohet me faktin se sipas artikullshkruesit, kjo gjykatë kishte marrë një vendim duke rrëzuar kërkesën e drejtësisë italiane për të ekstraduar ‘baronin’ G.Ç., i dënuar në vendin fqinj me 20 vite burg. Kjo fjali nuk është e saktë, sepse sikurse konstatohet lehtësisht, kërkesa për ekstradim nuk është rrëzuar, por Gjykata e Apelit ka prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, sepse ka vlerësuar të parregullt procesin e zhvilluar prej saj. Kam mendimin se çështja e parë që shtrohet në këto raste, edhe përpara opinionin publik, është evidentimi saktësisht i veprimeve a mosveprimeve të organit përkatës që ka ndikuar në dështimin e kërkesës për ekstradim. Kështu, si letër porosia e kërkuar nga Gjykata e Tiranës që nuk është ekzekutuar nga Ministria e Drejtësisë, ashtu edhe mosverifikimi i pretendimit të mbrojtësit të shtetasit G.Ç., për dënimin e tij për të njëjtin fakt me vendim të gjykatës shqiptare (si një kusht pengues për ekstradimin), janë dy çështjet thelbësore që përcaktojnë edhe fatin e çështjes dhe që dëshmojnë njëkohësisht edhe për mosveprimin e autoriteteve shtetërore përkatëse.*

*Do të doja të theksoja se gjatë gjithë veprimtarisë time jam orientuar përherë nga parimi se liritë dhe të drejtat e njeriut të mbrojtura nga Kushtetua e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, përbëjnë bazën e një shoqërie demokratike dhe mbrojtja e tyre nga çdo shkelje e kryer, nuk vihet në diskutim, pavarësisht rrethanave, fakteve apo individit që i gëzon këto të drejta.*

*Në parim, askush nuk mund t’i ndajë njerëzit në ‘të mirë’ dhe ‘të këqij’ dhe ndërsa të parët, duhet të marrin mbrojtje në gjykatë, të dytët nuk e paskan këtë të drejtë dhe vetëm, sepse publiku i njeh për cilësitë e tyre negative, ata nuk mund të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave themelore që i garantohen çdo individ.*

*Në rastin në shqyrtim, situata ishte edhe më e rëndë, sepse kufizimi i lirisë së shtetasit G.Ç., me masën shtrënguese ‘arrest në shtëpi’, ishte i paligjshëm edhe për shkak të përfundimit vlerë kohë më parë të afatit të kufizimit. Sikurse jam shprehur në mendimin e pakicës, liria e personit si një nga të drejtat themelore mund të kufizohet vetëm me ligj (neni 17 i Kushtetutës dhe neni 5.1 i KEDNJ-së) dhe ligji që përcakton kushtet e kufizimit të lirisë është Kodi i Procedurës Penale. Ky Kod lejon kufizimin e lirisë në çështjet e ekstradimit, duke aplikuar masat shtrënguese të sigurimit, por për këtë përcaktohen afate. Me përfundimin e afateve të caktuara me ligj, kufizimi i lirisë është i ndaluar dhe kjo nuk është çështje e vlerësimit të gjyqtarit, kjo është një çështje e ligjit. Gjyqtari mund të vlerësojë proporcionalitetin e masës shtrënguese, duke aplikuar atë që është më e përshtatshme për secilin rast, por kur kufizimi i lirisë nuk lejohet ligjërisht të kryhet, kjo duhet të konstatohet nga gjykata dhe të rivendoset e drejta e cenuar, duke liruar personin e dëmtuar. Ky veprim është i detyrueshëm, për të përmbushur*



detyrimin pozitiv të shtetit për të ndaluar gjendjen e paligjshme, lidhur me kufizimin e lirisë së individit.

Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, ishte evident fakti se masës shtrënguese 'arrest në shtëpi' që i ishte caktuar shtetasit G.Ç., i kishte përfunduar afati dhe ai qëndronte i izoluar, pa një vendim gjyqësor. Vendimi i Gjykatës së Apelit, që vlerësoi të përshtatshme me nevojat e sigurimit masën e 'arrestit në shtëpi', në vlerësimin tim personal, përbën një masë të re të caktuar ndaj tij, pa një kërkesë të prokurorit dhe pa një parashikim në ligj. Në rastet e ekstradimit justifikohet ligjërisht kufizimi i lirisë së individit, për të cilin kërkohet ekstradimi, por njëkohësisht vendosja e afateve të masës shtrënguese është në përputhje me nenin 5.1 të KEDNJ-së dhe praktikën e GJEDNJ-së, që obligojnë procedura të shpejta nga autoritetet shtetërore.

Si përfundim, për t'i dhënë përgjigje kërkesës suaj për shpjegim, vendimi i Gjykatës së Apelit, që e prishi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhet ngushtësisht me evidentimin e procesit të parregullt (përfshirë këtu edhe mosveprimin në kohë të Ministrisë së Drejtësisë për t'i dhënë rrugë sa më shpejt letërporosisë), duke kërkuar që kërkesa për ekstradim të shqyrtohet në përmbushje të garancive ligjore të personit të dënuar në Itali. Për pjesën tjetër të vendimit, unë kam mbetur në pakicë për arsyet e lartpërmendura. Në këto kushte, denoncimi mediatik, është i përligjur për sa i përket dështimit të procesit në shkallë të parë dhe interesit publik për të marrë informacion për drejtësinë penale, ndërkohë që nuk përçon me vërtetësi dhe objektivitet vendimin e Gjykatës së Apelit që, ndryshe nga sa publikohet, nuk e rrëzoi kërkesën për ekstradim dhe as e liroi nga burgu shtetasin G.Ç.

▪ Pas analizimit të denoncimit mediatik, duket se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

161. Pas vlerësimit të fakteve dhe dokumentacionit mbi denoncimet nuk u vërejtën fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhëna apo *indicie* për subjektin e rivlerësimit, për të vijuar me hetime të mëtejshme.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4 dhe në germen "a", pika 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Petri, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.6.2020.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Xhensila PINE**  
**Anëtare**  
**(Kundër)**

Sekretare gjyqësore  
Fiorela Mandro